

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5940
E martë, 26 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Votat e diasporës e mbajnë
pezull certifikimin e
rezultatit të zgjedhjeve

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAVIT JASHARI | FAQE 4-5



SPECIALJA TË MERRET EDHE ME KRIMET E SERBËVE

Kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, ka ftuar institucionet e reja që të bëjnë diçka në raport me Gjykatën Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse është

i pamundshëm shfuqizimi i Speciales atëherë kjo gjykatë duhet të merret edhe me krimet e serbëve gjatë luftës në Kosovë. Jashari beson se pretendenti për kryeministër, Albin Kurti, i cili e ka kundërshtuar formimin e

kësaj gjykate, do t'i marrë parasysh kërkesat e tyre në këtë drejtim. "Tani mendoj se është koha që Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë mundësinë që, të paktën, Gjykata Speciale të mos jetë gjykatë selektive", ka thënë Jashari

**Sindikatat
paralajmërojnë
pasoja nëse
nuk zbatohet
Ligji për pagat**

FAQE 9



KRESHNIK GASHI EMËROHET DREJTOR I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR INTELIGJENCË (AKI), NDËRKAQ BURIM RAMADANI INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM I KËTIJ INSTITUCIONI

Emërimet në AKI vlerësohen të kundërligjshme

FAQE 3

Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri në largim Ramush Haradinaj kanë emëruar të hënën drejtor të ri të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Kreshnik Gashin, kurse inspektor të përgjithshëm të AKI-së, Burim Ramadanin. Këto dy emërimet nuk janë mirëpritur mirë nga njohësit e proceseve politike dhe nga partia që i ka ftuar zgjedhjet e 6 tetorit, Lëvizja Vetëvendosje, pasi që kanë theksuar se janë emërimet të kundërligjshme. Zyrtarët e kësaj partie kanë bërë me dije



se këto vendime do të zhvlerësohen me formimin e qeverisë nga Albin Kurti

OPINION

GJUHA JONË E LASHTË F. 12



Sadulla DURAKI - Zëvendëskryeminister dhe Minister për Sistem Politik dhe Mardhënie Ndërmjet Bashkësive në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

TREPÇA F. 11

Mr. sc. Bislim L. FETAHAJ

AKTUALE

KURTI PARALAJMËRON DISKUTIME ME BRUKSELIN PËR SPECIALEN F. 5

GJENERALI AMERIKAN URON KOMANDANTIN E FSK-së PËR DITËN E FORCËS F. 6



EKONOMI

GLPS E QUAN TË JASHTËLIGJSHËM VENDIMIN E BQK-së PËR SHITJEN E SIGURIMIT TË AUTOMJETEVE F. 8

NË KONVENTËN E BIZNESEVE KËRKOHEM KRIJIMI I MUNDËSIVE PËR INVESTIMET E DIASPORËS F. 8

SPORT

LIMANI: BALLKANIN, SI NË KAMPIONAT, E MPOSHTIM EDHE NË KUPË F. 16

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Cakaj: Roli i shqiptarëve, i patjetërsueshëm në mbështetje të proceseve euroatlantike në Ballkan

TIRANË, 25 NËNTOR - Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka thënë se roli i shqiptarëve është i patjetërsueshëm në mbështetje të proceseve euroatlantike në Ballkanin Perëndimor. "Sot filluam me Konferencën e Tiranës! Kjo konferencë do t'i mbledhë të gjithë përfaqësuesit e lartë politikë shqiptarë nga rajoni në baza

vjetore me qëllim të krijimit të platformave të përbashkëta veprimi dhe bashkërendim të qëndrimeve politike në shërbim të afirmimit të interesave kombëtare!", tha Cakaj. "Roli i shqiptarëve është i patjetërsueshëm në mbështetje të proceseve euroatlantike në Ballkanin Perëndimor! Sidoqoftë, procesi i integritimit euroatlantike nuk zëvendëson domosdoshmërinë

e thellimit të bashkëpunimit mbarëkombëtar! Këtu veçanërisht duhet theksuar rëndësia e bashkërendimit të plotë të politikës së jashtme mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë! Thellimi i marrëdhënieve brenda shqiptareve është sa detyrë kombëtare e historike aq edhe interes politikë strategjik", ka shkruar Cakaj në logarinë e vet në "Facebook".



NATO-ja ekspozon bazën raketore në Rumani

Në prag të Samitit të NATO-s, që do të mbahet më 3 dhe 4 dhjetor në Londër, aleanca e ka hapur bazën raketore në Rumani për një turne nga gazetarët dhe ambasadorët në Rumani të 20 shteteve anëtare të NATO-s

BRUKSEL, 25 NËNTOR - Sistemi i NATO-s për mbrojtje raketore, i vendosur në jug të Rumanisë, ka qenë shkak i grindjeve midis aleancës dhe Rusisë prejse i ka nisur operacionet në fillim të vitit 2016.

Rusia pretendon se sistemi, së bashku me një bazë të ngjashme të NATO-s në Poloni, kanë për qëllim të minojnë mbrojtjen bërthamore të Moskës.

Në prag të samitit të NATO-s, që do të mbahet më 3 dhe 4 dhjetor në Londër, aleanca e ka hapur atë për një turne nga gazetarët dhe ambasadorët në Rumani të 20 shteteve anëtare të NATO-s.

Vizita e javës së kaluar ka qenë e para e një grupi civilësh në bazën që ndodhet në qytetin Deveselu - rreth 180 kilometra në perëndim të Bukureshtit.

Ministri rumun i Mbrojtjes, Nicolae Ciuc, ka thënë se turneu ka qenë një iniciativë transparente, për të treguar që objekti prej 1 miliard dollarësh ka "natyrë thjesht mbrojtëse".

Komandanti i Marinës amerikane, i ngarkuar për objektin, i ka hedhur poshtë pre-

tendimet e Kremlinit, duke thënë se ai është i dizajnuar vetëm për të mbrojtur Evropën nga sulmet e mundshme të raketave balistike, të nisura nga Lindja e Mesme. "Gjëja e vetme që kemi është aftësia për të lëshuar intercepore bllokues SM-3 Block IB për raketat balistike që hyjnë nga Irani", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" komandanti John Fitzpatrick. "Kjo bazë aktualisht nuk ka kapacitete të tjera. Do të duheshin ndryshime të gjera, ndryshime në shkallë industriale, për të pasur ndonjë dallim", ka shtuar ai.

Në Qendrën e operimit të objektit, ambasadorët dhe gazetarët janë lejuar të shohin tastierat që përdor Marina amerikane për të kontrolluar mburojën raketore, e cila kurrë nuk ka hedhur ndonjë raketë dhe e ka të ndaluar të kryejë ndonjë provë.

Secili stacion operimi në Deveselu ka tre ekrane kompjuterësh, së bashku me sistemet e komunikimit dhe çelësat e lëshimit të raketave, në përgjigje të ndonjë raketë sulmuese në Evropë.

Ambasadorët në turne janë



mblendhur gjithashtu në një sallë, ku zyrtarët ushtarakë amerikanë dhe rumunë i kanë shpjeguar detektorët që paralajmërojnë për sulme raketore.

Në total kanë qenë rreth 500 ushtarë rumunë, 250 trupa amerikane dhe personel tjetër që punon në bazë. "Ne punojmë së bashku edhe nëse jemi tri njësi. Misioni ynë është ta mbajmë sistemin funksional 24 orë në ditë", ka thënë komandanti i bazës rumune, kolonel Razvan Bratulescu.

Rusia është ankuar për zgjerimin e NATO-s me vendet që gjatë kohës sovjetike kanë qenë pjesë e Bllokut Lindor, por anëtarët lin-

dore të NATO-s e shohin aleancën si burimin kryesor të sigurisë përballë agresionit në rritje të Rusisë. Rumania, e cila është anëtarësuar në NATO më 2004, gjithashtu e konsideron partneritetin e saj strategjik me Shtetet e Bashkuara si një garantues të sigurisë. Por, shqetësimet në aleancë janë rritur qysh në fillim të nëntorit kur presidenti i Francës, Emmanuel Macron, i ka thënë revistës "The Economist" se Evropa nuk mund të mbështetet më te Shtetet e Bashkuara për mbrojtjen e aleatëve të NATO-s. "Ajo që ne po përjetojmë tani është vdekja në tru e NATO-s", ka thënë Macroni. Ambasadorja e Francës në

Rumani, Michele Ramis, ka thënë gjatë turneut në Deveselu se "nuk e komenton strukturën e NATO-s". "Ajo që ka thënë presidenti është se struktura ushtarake, zinxhiri i komandës po funksionon shumë mirë", ka thënë Ramis. "Ai thjesht ka thënë se nga këndvështrimi politik, do të dëshiron të kishte më shumë konsultime midis aleatëve të NATO-s", ka thënë Ramis. "Ai nuk po fliste për vlerën e strukturës", ka shtuar ajo. Këto çështje pritet të ngrihen në Londër, kur liderët e NATO-s të mblidhen për të shënuar 70-vjetorin e aleancës dhe për të diskutuar drejtimin e saj të ardhshëm.

Rama: Shengeni rajonal, një nga 7 prioritetet e qeverisë

TIRANË, 25 NËNTOR - "Kush është kundër Shengenit rajonal nuk kupton asnjë gjë fare, nuk kupton nga çdo pozitë, nga pozita më nacionaliste deri te pozita më liberale", tha të hënën kryeministri shqiptar, Edi Rama. Kryeministri e renditi Shengenin rajonal si një nga 7 prioritetet e qeverisë në 2 vitet e ardhshme. "Një gjë është e sigurt Shengeni rajonal, e para është një vizion dhe një këm-

bëngulje nga ana ime qysh në ditën e parë të procesit të Berlinit. Ka qenë i penguar deri para pak muajsh nga presidenti i Serbisë, me të cilin unë kam bërë pafundësi debatesh e komunikimesh për këtë. Nuk mund të bëjmë dot një marrëveshje rajonale mbi tregtinë nëse nuk bëjmë një marrëveshje rajonale mbi lëvizjen e lirë të njerëzve. Domethënë që do bashkohet Shqipëria me

Kosovën, do hapet kufiri, sepse marrëveshje e lëvizjes së lirë të njerëzve do të thotë që kufiri i sotëm mes Shqipërisë dhe Kosovës, që sa herë është thënë do të hapet dhe është aty akoma, të hapet", tha Rama. "Nuk po flas për të gjitha efektet e tjera dhe të mirat e tjera dhe pse kjo e forcon Kosovën dhe Shqipërinë, nuk e dobëson; e vendos Kosovën në një pozicion më të favorshëm edhe me

Serbinë, nuk e dobëson; dhe se pse politika e mbylljes dhe politika e vetërrethimit është politikë vetëvrasëse për Kosovën", tha Rama. "Historia nuk shkruhet duke ndenjur në shtëpi dhe duke bërë patriotin me pizhame. Sot ka plot që nuk e kuptojnë, do ta kuptojnë nesër. Ne nuk jemi zgjedhur për t'i ndjekur ata që nuk kuptojnë, ne jemi zgjedhur për të udhëhequr. Ne nuk jemi zgjedhur që çdo gjë



që bëjmë t'i pëlqejë gjithmonë shumicës, ne jemi zgjedhur që edhe kur shumica nuk është dakord se nuk i pëlqen diçka, por ama ne e shohim, të udhëheqim drejt asaj që shohim", tha Rama.

Kreshnik Gashi emërohet drejtor i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), ndërkaq Burim Ramadanin inspektor i përgjithshëm i këtij institucioni

Emërimet në AKI vlerësohen të kundërligjshme



Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri në largim Ramush Haradinaj kanë emëruar të hënën drejtor të ri të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Kreshnik Gashin, kurse inspektor të përgjithshëm të AKI-së, Burim Ramadanin. Këto dy emërimet nuk janë mirëpritur mirë nga njohësit e proceseve politike dhe nga partia që i ka fituar zgjedhjet e 6 tetorit, Lëvizja Vetëvendosje, pasi që kanë theksuar se janë emërimet të kundërligjshme. Zyrtarët e kësaj partie kanë bërë me dije se këto vendime do të zhvlerësohen me formimin e qeverisë nga Albin Kurti

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, kanë emëruar të hënën drejtor të ri të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Kreshnik Gashin, kurse inspektor të përgjithshëm të AKI-së, Burim Ramadanin. "Ky vendim është marrë bazuar në nenin 84, paragrafin 21, bazuar në nenin 94, paragrafin 8, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës", është bërë me dije në njoftimin e Presidencës së Kosovës. Për këto dy emërimet ka njoftuar edhe kryeministri në largim, Ramush Haradinaj. "Në bazë të kompetencave

kushtetuese dhe ligjore dhe në bashkërendim me presidentin, sot kam emëruar Kreshnik Gashi në postin e Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, ndërsa Burim Ramadanin në postin e Inspektorit të Përgjithshëm të AKI-së. Profilët e të emëruarve, si figura publike me integritet dhe ekspertë për siguri, garantojnë profesionalizmin dhe kredibilitetin e AKI-së", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kreshnik Gashi ka mbajtur pozitën e kryetarit të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP), kurse Ramadanin ka qenë zëvendësministër i Mbrojtjes. Ky vendim i Haradinajt vjen pasi

ditë më parë Shpend Maxhuni ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Maxhuni ishte emëruar në këtë pozitë në prill të vitit të kaluar. Para kësaj pozite ai ka qenë drejtor i Policisë së Kosovës.

Rreth këtyre dy emërimeve ka reaguar analisti politik Blerim Vela, i cili ka thënë se politizimi i institucioneve shtetërore ishte arsyeja pse PDK-ja dhe AAK-ja i humbën zgjedhjet por, sipas tij, këto parti po vazhdojnë kapjen e shtetit edhe në periudhën paszgjedhore. "Kjo tregon sa pak integritet kanë politikanët e gjeneratës së 'cubokracisë'. Qeveria e re LV dhe LDK duhet ta 'çlirojnë' secilin institucion shtetëror nga aparatçikët politikë dhe t'i lejojnë profesionistët

që janë besnikë vetëm ndaj interesit shtetëror dhe Kushtetutës t'i udhëheqin ato", ka shkruar Vela në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe analisti tjetër politik, Armend Muja, ka thënë se këto nominime janë të gabuara për tri arsye: janë të kundërligjshme, nuk përfaqësojnë realitetin politik dhe kandidaturat janë politike. "Kushtetuta e Kosovës (neni 94.8) parasheh që kryeministri së bashku me presidentin emërojnë drejtorin dhe Inspektorin e AKI-së. Megjithatë, z. Haradinaj nuk është kryeministër i Kosovës. Ai është ish-kryeministër që ka dhënë dorëheqje të parevokueshme. Kandidaturat nuk janë apatiake siç e kërkon Ligji për AKI-në (Neni 17). Punonjësit e AKI-së nuk mund të jenë anëtarë të partive politike. Unë nuk kam informacion të plotë për z. Gashi, por është e evidente që z. Ramadanin ishte kandidat politik në zgjedhjet 2019", ka shkruar Muja në llogarinë e vet në "Facebook". Muja ka thënë se në krye të AKI-së nuk duhet të vijë persona me të kaluar apo anë-

tarë të partive politike apo që perceptohen si të tillë.

Mefail Bajqinovci nga Lëvizja Vetëvendosje ka reaguar pas vendimit të kryeministrit në detyrë, Ramush Haradinaj dhe presidentit Hashim Thaçi për emërimin e shefit të AKI-së e inspektorit të përgjithshëm. Bajqinovci ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", se kapja e institucioneve të sigurisë po vazhdon. Ai ka shkruar se PDK-ja dhe AAK-ja i kanë kapur brutalisht dy institucione të sigurisë duke emëruar në to eksponentë të vet në pozita kyçe. "PDK-ja dhe AAK-ja i kapin brutalisht dy institucionet e sigurisë siç janë AKI-ja dhe Inspektorati i AKI-së duke i emëruar eksponentët e vet në pozita kyçe. Ish-sekretari i MPJ-së, Kreshnik Gashi, në kohën kur Hashim Thaçi ishte ministër i Jashtëm, tani u emërua drejtor i AKI-së. Burim Ramadanin zyrtar i AAK-së emërohet kryeinspektor i AKI-se. Kapja e institucioneve me njerëz partiakë po vazhdon. Këto vendime do të zhvlerësohen me ardhjen e qeverisë Kurti", ka thënë Bajqinovci.

Të mërkurën shënohet Dita e Forcës - Ushtrisë së Kosovës



PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Ceremonia e Ditës së Forcës - Ushtrisë së Kosovës do të mbahet të mërkurën në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, në orën 11:00.

Në ceremoni do të marrin pjesë presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministri i Kosovës,

Ramush Haradinaj, ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, gjeneralë, oficerë, mysafirë, personalitete shtetërore dhe akademike.

Me fjalë tematike do të paraqiten presidenti Hashim Thaçi,

kryeministri Ramush Haradinaj dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Në fund të ceremonisë do të ndahen dekorata dhe mirënjohje për stafin e dalluar të Ministrisë së Mbrojtjes dhe oficerët dhe nënoficerët e dalluar të FSK-së.

Flet për "Epokën e re", Xhavit Jashari

Specialja të merret edhe



Kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, ka ftuar institucionet e reja që të bëjnë diçka në raport me Gjykatën Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nëse është i pamundshëm shfuqizimi i Speciales, atëherë kjo gjykatë duhet të merret edhe me krimet e serbëve gjatë luftës në Kosovë. Jashari beson se pretendenti për kryeministër, Albin Kurti, i cili e ka kundërshtuar formimin e kësaj gjykate, do t'i marrë parasysh kërkesat e tyre në këtë drejtim. "Tani mendoj se është koha që Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë mundësinë që, të paktën, Gjykata Speciale të mos jetë gjykatë selektive", ka thënë Jashari

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve, Xhavit Jashari, ka bërë me dije se qëndrimi i organizatave të dala nga lufta e UÇK-së është shfuqizimi i Gjykatës Speciale. Ai ka deklaruar se nëse kjo është e pamundshme, atëherë kjo gjykatë duhet të merret edhe me krimet e serbëve gjatë luftës në Kosovë.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Jashari i ka ftuar institucionet e reja, të cilat do të formohen pas certifikimit të zgjedhjeve, që t'i marrin parasysh kërkesat e tyre. "Tani

mendoj se është koha që Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë mundësinë që, të paktën, Gjykata Speciale të mos jetë gjykatë selektive. Nëse ndërkom-bëtarët e kanë seriozisht, dihet se kush ka bërë krime në luftën e Kosovës dhe kush janë kriminelët. Kërkesa jonë në radhë të parë është që të shfuqizohet kjo gjykatë. Por, nëse nuk ekzistojnë mundësitë për një gjë të tillë, atëherë kjo gjykatë duhet të merret edhe me krimet serbe në Kosovë. Pra, nuk duhet t'i lihet hapësirë kësaj gjykate që t'i hetojë vetëm ish-ushtarët e UÇK-së", ka thënë Jashari.

Ai beson se pretendenti për kryeministër, Albin Kurti, i cili e

ka kundërshtuar formimin e kësaj gjykate, do t'i marrë parasysh kërkesat e tyre. "Tani me krijimin e qeverisë së re, nëse ata që bashkë me neve dikur kanë kundërshtuar këtë gjykatë, vazhdojnë të kenë qëndrime të njëjta, na bëjnë të besojmë në këtë drejtim. Besojmë se të paktën të ngritët zëri i kundërshtimit ndaj kësaj gjykate, sepse Kosova nuk duhet të vazhdojë të trajtohet si laborator i eksperimentimit, duke fyer ata djem dhe vajza që nuk kursyen asgjë për të ardhur deri te liria", është shprehur ai.

Në këtë intervistë Jashari ka folur edhe për ftesat e shumta që Specialja po dërgon për ish-

pjesëtarët e UÇK-së. Ai ka thënë se kjo për organizatat e dala nga lufta është shqetësuese. "Ne e përcjellim me vëmendje gjithë procesin dhe ftesat që i bënë kjo gjykatë. Unë do t'i ftoja të gjithë ata që thirren nga kjo gjykatë të qëndrojnë dinjitozë sepse lufta jonë çlirimtare ka qenë e pastër dhe e drejtë. Vetë ftesat e Speciales për strukturën udhëheqëse të UÇK-së e arsyetojnë tendencën e asaj që përmenda më herët, se qëllimi i saj është njollosja e luftës. Nuk mund të thuhet më se po thirren vetëm individët, kur thirren të gjitha ata që kanë qenë në strukturat udhëheqëse të UÇK-së", ka deklaruar Jashari.

"Epoka e re": Z. Jashari, organizatat e dala nga lufta e UÇK-së vazhdimisht e kanë kundërshtuar Gjykatën Speciale. Tani kur jemi në pritje të formimit të qeverisë së re, e cila do të udhëhiqet nga z. Albin Kurti, i cili e ka kundërshtuar këtë gjykatë, cilat janë pritjet tuaja?

Jashari: Ne bashkërisht edhe me z. Kurti dhe me shumë deputetë në vitin 2015 kemi organizuar protesta për ta kundërshtuar themelimin e kësaj gjykate, ku herën e parë kishim pamundësuar themelimin e saj. Ne kemi menduar dhe po del të jetë kështu, se Gjykata Speciale ka qenë fyerja më e madhe që i bëhet luftës së UÇK-së dhe popullit të saj. Gjithashtu, kemi konsideruar se, përveç fyerjes që i bëhet shtetit të Kosovës, një gjykatë e tillë suprimon organet e drejtësisë dhe është në shpërputhje me Kushtetutën e Kosovës. Ne ende mbrojmë të njëjtat qëndrime rreth kësaj gjykate. Pra, Gjykata Speciale është e papranueshme, është

me krimet e serbëve

se është koha që Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë mundësinë që, të paktën, Gjykata Speciale të mos jetë gjykatë selektive. Nëse ndërkombëtarët e kanë seriozisht, dihet se kush ka bërë krime në luftën e Kosovës dhe kush janë kriminelët. Kërkesa jonë në radhë të parë është që të shfuqizohet kjo gjykatë. Por, nëse nuk ekzistojnë mundësitë për një gjë të tillë, atëherë kjo gjykatë duhet të merret edhe me krimet serbe në Kosovë. Pra, nuk duhet t'i lihet hapësirë kësaj gjykate që t'i hetojë vetëm ish-ushtarët e UÇK-së kur dihen botërisht qëllimet dhe tendencat e kësaj gjykate, e që janë njollosja e luftës çlirimtare të Kosovës dhe barazimi me krimin dhe kriminelët serbë që kanë bërë krime në Kosovë.

"Epoka e re": Sa jeni optimist për arritjen e këtij qëllimi, sepse kërkesa të tilla ju keni bërë edhe më herët, por që nuk janë marrë parasysh?

Jashari: Ju e dini se kjo gjykatë është kundërshtuar nga ne si diçka e pranueshme. Kërkesat tona për këtë qëllim kanë qenë të vazhdueshme, pra sa herë na është dhënë mundësia. Tani me krijimin e qeverisë së re, nëse ata që bashkë me ne dikur e kanë kundërshtuar këtë gjykatë, vazhdojnë të kenë qëndrime të njëjta, na bëjnë të besojmë në këtë drejtim. Besojmë se, të paktën, do të ngritët zëri i kundërshtimit ndaj kësaj gjykate. Kosova nuk duhet të vazhdojë të trajtohet si laborator i eksperimentimit, duke fyer ata djem dhe vajza që nuk kursyen asgjë për të ardhur deri te liria.

"Epoka e re": Së fundi është shtuar intensiteti i ftesave të Speciales për ish-ushtarët e UÇK-së. Sa shqetësuese ka qenë për ju kjo?

Jashari: Është shqetësuese. Ne e përcjellim me vëmendje gjithë procesin dhe ftesat që i bënë kjo gjykatë. Unë do t'i ftoja të gjithë ata që thirrën nga kjo gjykatë, që të qëndrojnë dinjitozë, sepse lufta jonë çlirimtare ka qenë e pastër dhe e drejtë. Vetë ftesat e Speciales për strukturën udhëheqëse të UÇK-së e arsyetojnë tendencën e asaj që përmenda më herët, se qëllimi i saj është njollosja e luftës. Nuk mund të thuhet më se po thirren vetëm individët, kur thirren të gjitha ata që kanë qenë në strukturat udhëheqëse të UÇK-së.

"Epoka e re": Në fakt, ftesa për intervistim Specialja ka pasur edhe ndaj njerëzve që nuk kanë qenë pjesë e UÇK-së. Kemi rastin e ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri. Pse mendoni se

po ndodh kjo?

Jashari: Kjo në një farë forme është për ta arsyetuar këtë gjykatë në aspektin politik. Ne këto i kemi kuptuar në vazhdimësi, sepse kjo është një lojë politike se, gjoja, një gjykatë e tillë është e interesuar që të vendoset drejtësia.

Mendoj se është shumë e padrejtë që të thirren edhe njerëz të cilët nuk kanë qenë pjesë e UÇK-së.

"Epoka e re": Është paralajmëruar se organizatat e dala nga lufta do të organizojnë protesta, por ende nuk kemi

parë asgjë në këtë drejtim?

Jashari: Ne jemi duke pritur për këtë çështje. E vetmja pengesë e jona në këtë drejtim është se kjo gjykatë është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Por, nëse protestojmë, ne do ta kemi adresë të saktë se kujt do t'i drejtohem me këtë protestë.

Kurti paralajmëron diskutime me Brukselin për Specialen

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Nga organizatat e veteranëve të luftës tashmë kanë nisur thirrjet për institucionet e ardhshme të Kosovës që të refuzojnë ta vazhdojnë mandatin e kësaj gjykate, para se gjithash, për shkak se e konsiderojnë të njëanshme dhe, siç thonë, ajo do të gjykojë vetëm një bashkësi etnike, ndërkohë që, sipas tyre, krimet serbe në Kosovë do të mbeten të padënuara. Njohësit e Kushtetutës së Kosovës theksojnë se vetëm një amendament i ri kushtetues mund t'ia vazhdojë mandatin gjykatës, ndërkaj që udhëheqësit politikë po paralajmërojnë se kjo çështje do të jetë temë e diskutimit në legjislaturën e ardhshme në Kuvendin e Kosovës.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili është pretenduesi kryesor për kryemi-

nistër të Kosovës, në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se qeveria e re dhe ai si kryeministër lidhur me Gjykatën Speciale do të shtojnë dy diskutime. "Njërin (diskutim) parlamentar në Kuvendin e Republikës, mbi Gjykatën Speciale, e cila ka shpenzuar më shumë se 100 milionë euro të taksapaguesve evropianë dhe nuk ka ngritur asnjë aktakuzë e lëre më të shpie deri në fund ndonjë proces. Dhe, në anën tjetër, një diskutim me Brukselin mbi këtë ngrehinë të pazakonshme të drejtësisë. Prej këtyre diskutimeve duhet ta marrim vendimin meritore në vitin e ardhshëm", ka thënë Kurti. Kurti, subjekti politik i të cilit në vitin 2015 ka votuar kundër ndryshimeve kushtetuese për formimin e kësaj gjykate, përkujton se që nga fillimi ka qenë skeptik lidhur me

drejtësinë që mund të arrihet në atë gjykatë. Ai ka shtuar që, në vend të gjykatave speciale, Kosovës i nevojiten "gjykata normale, procese normale dhe drejtësi normale, por edhe që kriminelët e luftës dhe të paqes të jenë në burg". "Me funksionimin e gjykatave normale ne do ta bëjmë gjithnjë e më të panevojshme Gjykatën Speciale, e cila, ndonëse është gjykata më e re për Kosovën, ajo nuk është e re, sepse së shpejti bëhen katër vjet e gjysmë të amendamentimit të Kushtetutës sonë për t'i bërë vend kësaj Gjykate Speciale, e cila me një këmbë është brenda vendit dhe me një këmbë është jashtë vendit. Rrjedhimisht, ajo është gjykatë 'sui generis' që, mbase, nuk do t'ia arrijë ta mbrojë dot veten në Strasburg, një ditë", ka thënë Kurti.



selektive dhe qëllimi i vetëm i saj është njollosja e luftës çlirimtare të Kosovës dhe që ta barazojë luftën çlirimtare dhe pjesëtarët e saj me krimet dhe kriminelët serbë që kanë kryer krime në Kosovë me urdhra shtetërore. Ne vazhdimisht kemi kërkuar që të shqyrtohen mundësitë nga organi më i lartë në vend, nga Kuvendi i Kosovës, që të shfuqizohet një gjykatë e tillë. Nëse shfuqizimi është i pamundshëm, të paktën të mos ndodhin raste selektive, që me pretendime të Dik Martit të hetohen vetëm pjesëtarët e UÇK-së. Si organizata të dala nga lufta e UÇK-së kemi deklaruar se lufta çlirimtare ka qenë e drejtë dhe e pastër. Kjo është vërtetuar në instancat më të larta të drejtësisë ndërkombëtare siç ka qenë Gjykata e Hagës.

"Epoka e re": Pra, ju do të kërkonin nga legjislatura e re dhe qeveria e re, që në vitin 2020, nëse i duhet vazhdimi i mandatit kësaj gjykate, të hetohen edhe krimet serbe gjatë luftës?

Jashari: Gjithsesi. Tani mendoj

Gjenerali amerikan uron komandantin e FSK-së për Ditën e Forcës



PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletënant Rrahman Rama, me rastin e Ditës së Forcës ka marrë letër urimi nga kryetari i Stafëve të Përbashkëta të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjenerali i Ushtrisë së ShBA-së, Mark A. Milley. "Urime për ju, burrat dhe gratë e Forcës së Sigurisë të Kosovës, me rastin e festës së Ditës së Forcës të Sigurisë së Kosovës. Në këtë përvjetor të rëndësishëm unë vlerësoj lart përkushtimin tuaj për kryerjen operacioneve në përgjigje ndaj krizave dhe operacioneve për mbrojtje civile në Kosovë. Puna juaj për të krijuar një forcë të integruar është demonstruar në iniciativat dhe reformat sociale të lidershit të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Ushtria e ShBA-së vlerëson përkushtimin e lidershit tuaj dhe partneritetin tonë me Forcën e Sigurisë së Kosovës. Urimet më të mira për këtë rast të veçantë!", përfundon urimin e tij kryetari i Stafëve të Përbashkëta të Ushtrisë së ShBA-së, gjenerali Mark Milley.

Zgjedhet kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Këshillit Drejtues të UShAF-it

FERIZAJ, 25 NËNTOR (ER) - Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) të hënën janë zgjedhur kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i Këshillit Drejtues (KD). Kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i KD-së u zgjedhën nga radhët e anëtarëve të caktuar nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë siç parashihet me dispozitat ligjore

në fuqi dhe aktet normative të universitetit. Me shumicë votash kryesuesi i KD-së u zgjodh Samet Dalipi, ndërsa zëvendëskryesuesi Shaqir Ukshini. Kryesuesi Samet Dalipi ka falënderuar anëtarët e KD-së për besimin e dhënë dhe është zotuar se do t'i kryejë të gjitha punët me nder dhe përgjegjësi në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.



Një delegacion i Vetëvendosjes vizitoi Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Në Ditën Ndërkombëtare për Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave, një delegacion i Lëvizjes Vetëvendosje i përbërë nga deputetët Albulena Haxhiu dhe Arben Vitia dhe aktivistja Albesa Avdijaj kanë vizituar Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë në të cilën ofrohet strehim për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës.

Delegacioni i Lëvizjes Vetëvendosje gjatë vizitës u njoftua për problemet që ka kjo strehimore, e cila, në mungesë të vëmendjes nga qeveritë e deritanishme, ballafaqohet me telashe të mëdha, që nga buxheti i pamjaftueshëm e deri te mungesa e infrastrukturës. "Sot, në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Kundër Gruas, sikur edhe çdo ditë tjetër, ne duhet ta denoncojmë pa kompromis dhunën, shfrytëzimin e shtypjen sistematike që bëhet



kundër grave dhe fëmijëve. Veçanërisht ndaj atyre kategorive më të marginalizuara si pasojë e statusit të tyre ekonomik dhe social. Lëvizja Vetëvendosje në vazhdimësi është angazhuar për problemin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, posaçërisht për ndarje të buxhetit dhe insitucionalizim të strehimoreve gjithandë nëpër Kosovë", është thënë në njoftimin e LV-së. Sipas kësaj partie, duke e njohur

burimin e dhunës dhe format e manifestimit të saj, qeveria e ardhshme do të ndërhyjë shpejt dhe drejt për parandalimin, trajtimin dhe integrimin e viktimave të dhunës në shoqëri. "Bashkë me qeverinë e re do të sjellim edhe një mendësi e qasje të re në trajtimin e këtyre problemeve, me ç'rast angazhimi për eliminimin e të gjitha formave të dhunës do të jetë prioriteti ynë", është theksuar në njoftimin e LV-së.

Don Viktor Sopi nderohet me Medaljen "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu"

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, i ka ndarë Medaljen "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu", Don Viktor Sopi. Haradinaj ka thënë se me këtë

veprim ka shprehur mirënjohjen e tij dhe të qeverisë së vendit për veprën fisnike të Don Viktor Sopi dhe organizatës CARITAS Kosova që ai e drejton. "CARITAS Kosova, si

organizatë plotësuese e sistemit tonë të mbrojtjes sociale, përpos që ndër vite ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm humanitar në ndihmë dhe përkrahje qytetarëve në nevojë,

duke fuqizuar lidhjet tona me Perëndimin, ka ndikuar në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të gjenezës sonë kombëtare", ka thënë Haradinaj pas këtij takimi.



Votat e diasporës e mbajnë pezull certifikimin e rezultatit të zgjedhjeve

Një ankesë e Lëvizjes Vetëvendosje në adresë të Gjykatës Supreme ka bërë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të detyrohet ta presë vendimin e kësaj gjykate para se ta bëjë certifikimin e rezultatit përfundimtar. Gjykata Supreme ka afat 72 orë për marrjen e vendimit, ndonëse ky vendim mund të shpallet edhe më herët. Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar nga Supremja vlerësimin dhe marrjen e vendimit për rinumërimin e 392 pakove me fletëvotime të ardhura nga diaspora më 12 nëntor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Lëvizja Vetëvendosje e ka dërguar në Gjykatën Supreme çështjen e 392 pakove me fletëvotime nga diaspora që kishin rritur në adresë të KQZ-së më 12 nëntor. LV-ja përmes një komunikate për media të hënën ka theksuar se çdo votë e ardhur në adresë të KQZ-së dhe e nisur nga votues të regjistruar dhe brenda afatit duhet të numërohet dhe të përfshihet në rezultat përfundimtar. "Për sa kohë që vazhdon rinumërimi dhe ende pa u shpallur rezultatet, kemi kuptuar që në adresë të KQZ-së kanë arritur edhe 392 pako me fletëvotime të bashkatdhetarëve me të drejtë vote. Gjykata Supreme, në frymë dhe përmbajtje në dy raste të mëparshme ka konfirmuar të drejtën e votuesve nga mërgata që fletëvotimet e tyre të dërguara me kohë dhe para datës së zgjedhjeve të numërohen dhe të përfshihen në rezultat përfundimtar. Aktgjykimet e Gjykatës Supreme do të duhej të shërbenin si bazë e mjaftueshme që KQZ-ja ta bëjë edhe numërimin e këtyre 392 pakove, por pas refuzimit për t'i numëruar dhe refuzimit nga ana e PZAP-it për ta urdhëruar KQZ-në, çështjen e kemi adresuar në Gjykatën Supreme", është bërë me dije në njoftimin e Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas kësaj par-

tie, e drejta e votës si e drejtë kushtetuese dhe universale duhet të mbrohet dhe të respektohet. "Ndërsa çdo votë e ardhur në adresë të KQZ-së dhe e nisur nga votues të regjistruar dhe brenda afatit duhet të numërohet dhe të përfshihet në rezultat përfundimtar. Shumë shpesh disa palë të përfshira në proces kanë pretenduar se ankesat po e vonojnë certifikimin. Ju kujtojmë se faktori kryesor që ka shkaktuar këtë stërzgjatje të kalendarit të aktiviteteve të KQZ-së është Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. Ka një numër të konsiderueshëm të vendimeve arbitrare të këtij institucioni, të rinumërimeve, ndërhyrjes në rezultat. Dhe ajo çfarë është më arbitrare, është mosrespektimi i aktgjykimet të Gjykatës Supreme lidhur me votat e mërgatës. Në kushte normale, do të kishte mjaftuar vetëm një vendim i Gjykatës Supreme, që për të gjitha rastet e njëjta të vendosjes në analogji nga ana e KQZ-së dhe PZAP-it. Presim që Gjykata Supreme ta rikonfirmojë edhe një herë këtë të drejtë dhe ta urdhërojë numërimin e tyre pa humbur kohë", është theksuar në njoftimin e LV-së. Kjo ankesë e Lëvizjes Vetëvendosje në adresë të Gjykatës Supreme ka bërë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të detyrohet ta presë vendimin e kësaj gjykate para se ta bëjë certifikimin e rezultatit përfundimtar. Gjykata Supreme

ka afat 72 orë për marrjen e vendimit, ndonëse ky vendim mund të shpallet edhe më herët.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve thonë se pas konfirmimit nga Gjykata Supreme, se i është parashtruar ankesë ndaj vendimit të PZAP-it, rezultatet përfundimtare nuk mund të publikohen në këtë fazë. "Rezultatet nuk mund të publikohen pa ndonjë konfirmim në këtë rast nga PZAP-i dhe Gjykata Supreme se nuk kanë ndonjë çështje në shqyrtim", ka thënë zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi.

Çështje tjetër që mund ta mbajë pezull këtë proces ka të bëjë me kërkesën e Koalicionit Nisma Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë. Ky koalicion e ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese një ankesë, ku konteston vendimin e Gjykatës Supreme të 30 tetorit, ku u urdhërua Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të numërojë dhe të përfshijë në rezultat përfundimtar zgjedhor 4 639 fletëvotime të diasporës që kishin ardhur në Kosovë jashtë afatit ligjor.

Në ankesën e koalicionit Nisma-AKR-PD, kërkohet nga Gjykata Kushtetuese që ta vlerësojë kushtetutshmërinë e

këtij vendimi të Supremes. Koalicioni Nisma-AKR-PD, po ashtu, kërkon që Kushtetuesja të vendosë pro masës së përkohshme pasi, sipas këtij koalicioni, mosvënja e një mase

të tillë "mund të shkaktojë dëm të pariparueshëm dhe është në interes të publikut".

Ndërkaq të dielën ka përfunduar rinumërimi i votave nga 1 407 vendvotime.

Ilir Gashi: LV-ja nuk ka gatishmëri ta formojë qeverinë me LDK-në, po vonon certifikimin e zgjedhjeve

Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Ilir Gashi, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje me qëllim të vonimit të certifikimit të rezultateve ka bërë ankesë në pakot që janë pranuar për shkatërrim dhe jo numërim. Ky reagim i tij erdhi pasi Lëvizja Vetëvendosje ka njoftuar se çështjen e 392 pakove me fletëvotime nga diaspora që kanë arritur në adresë të KQZ-së më 12 nëntor e ka dërguar në Gjykatën Supreme. Gashi përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Lëvizja Vetëvendosje nuk ka gatishmëri ta formojë qeverinë me LDK-në dhe kjo, sipas tij, po shpërfaqet qartë në skenarët e saj përmes manipulimit të votave nga diaspora. "Se

Vetëvendosja nuk ka gatishmëri ta formojë qeverinë me LDK-në, kjo po shpërfaqet qartë në skenarët e saj përmes manipulimit të votave nga diaspora. Vetëm me qëllim të vonimit të certifikimit të rezultateve Vetëvendosja ka bërë ankesë në pakot që janë pranuar për shkatërrim dhe jo numërim! Këto pako janë: 1). Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare; 2). Pako që janë të destinuara për procedurën e shkatërrimit-asgjësimit të materialit zgjedhor; dhe 3). Në fakt, si material "sensitiv" është përdorur jashtë çdo procedure, pa mbikëqyrje, pa informim dhe pa përcjellje të policisë. Ato, në fakt, nuk janë as material sensitiv dhe për KQZ-në, janë të papërdorshme", ka shkruar Gashi.

Prokuroria Speciale ngrit aktakuzë ndaj tri grave të kthyer nga Siria



PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj tri grave të cilat akuzohen për veprat penale: pjesëmarrje në ushtri apo polici të huaj, organizim dhe pjesëmarrje në grupin militant Shteti Islamik (IS).

Në njoftimin e Prokurorisë Speciale të Kosovës thuhet se të tri gratë kishin udhëtuar nga Aeroporti i Prishtinës përgjatë periudhës 2013-2015, së pari në Stamboll e më pas i ishin bashkuar grupit militant IS-is në Siri, ku kanë qëndruar deri në

kthimin e shtetasve kosovarë nga këto vatra të luftës më 20 prill të këtij viti.

Sipas prokurorisë, një nga të akuzuarat kishte udhëtuar me burrin e që, sipas prokurorisë, thuhet se tashmë është i ndjerë dhe djalin e saj që në atë kohë ishte 1 vjet e gjysmë. E akuzuara tjetër, e cila është e mitur, kishte udhëtuar me bashkëshortin e saj, po ashtu të ndjerë, kurse e treta kishte udhëtuar e vetme.

Të tria gratë dyshohet se ishin pjesë e grupeve militante: Shteti Islamik dhe al-Nusra. Gjatë këtij

viti në Kosovë nga zona e konfliktit në Siri janë kthyer 110 shtetas kosovarë, prej tyre katër luftëtarë, 32 gra dhe 74 fëmijë, përfshirë këtu edhe nëntë fëmijë që kanë humbur prindërit në luftë.

Më shumë se 400 qytetarë të Kosovës, kryesisht të rritur, kanë shkuar në gjashtë-shtatë vjetët e fundit në Siri dhe Irak për të luftuar në anën e grupit militant Shteti Islamik. Më shumë se 70 prej tyre janë vrarë, ndërkohë që shumë gra dhe fëmijë kanë vazhduar të mbeten në atë zonë.

Në Konventën e Bizneseve kërkohet krijimi i mundësive për investimet e diasporës

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 NËNTOR - Konventa e Bizneseve të Diasporës dhe të Huaja, e cila organizohet nga Rrjetet e Bizneseve të Diasporës Shqiptare nga Evropa në bashkëpunim me USAID-in, ka hapur punimet të hënën për dy ditë me radhë në Prishtinë. Qëllimi i kësaj konvente është të krijojë rrjetëzimin dhe bashkëpunimin në mes të bizneseve të Kosovës, diasporës dhe atyre të huaja, duke i bashkuar në një pikëtakim, si dhe të ofrojë mundësi të integritimit në fushën e ekonomisë përmes takimeve B2B. Drejtori i Zyrës së USAID-it për zhvillim ekonomik, Joshua Mike, i ka përgëzuar bizneset nga diaspora që po vazhdojnë këtë traditë për t'i lidhur bizneset e Kosovës me tregjet e reja drejt Bashkimit Evropian. Duke e konsideruar si një hap

pozitiv mbajtjen e kësaj konference, Mike ka deklaruar se ngjarje të tilla ndihmojnë rritjen ekonomike në Kosovë. "Përmes vizitave në terren, duke biseduar në konventa të ndryshme, duke u takuar me udhëheqësit e bizneseve, është një optimizim i shëndetshëm për një të ardhme më të ndritur ekonomike dhe një element kritik i kësaj është marrëdhënia ndërmjet diasporës dhe udhëheqësve të bizneseve në nivel vendi. Jam impresionuar me kualitetin dhe kalibrin e ndërlikueshmërisë së sofistikimit të bizneseve që kam parë në teknologji informative, në përpunimin, biznesin e gjelbër dhe vazhdimisht i shoh se jeni duke përmirësuar proceset tuaja të certifikimit duke inkorporuar teknologjinë në veprimtarinë tuaj", ka thënë Mike, duke shtuar se të gjitha këto janë çelës për ruajtjen dhe krijimin e tregjeve të reja për një ekonomi

të orientuar kah eksporti që do të sjellë rritje dhe zhvillim këtë vendi. Kurse udhëheqësi i degëve të rrjetit të bizneseve të diasporës shqiptare në Evropë, Yll Blakaj, ka thënë se qëllimi i kësaj konvente është krijimi i një klimës për t'i rritur investimet në Kosovë. Blakaj u ka bërë thirrje bizneseve vendore dhe atyre të huaja t'i shfrytëzojnë këto takime për ta rritur tutje bashkëpunimin, derisa si kërkesë të veçanta nga kryetarët e komunave pati që ata ta shpalosin programin e tyre lidhur me diasporën. "Prodhuesit tanë të cilët tashmë prodhojnë edhe në Kosovë hapësirën e tregut evropian e gjejnë shumë më lehtë nëpërmjet këtyre evenimenteve të cilat kanë për qëllim edhe krijimin e besueshmërisë në mes të bizneseve të diasporës dhe bizneseve vendore këtu... Për të ardhur deri te suksesi na duhet punë dhe përkushtim,

megjithatë na duhet besueshmëria, të fillojmë t'i besojmë njëri-tjetrit si partnerë dhe biznese shqiptare. Tjetër zgjedhje nuk kemi", ka deklaruar Blakaj. Lazim Destani, kryetar nderi i Rrjetit të Bizneseve të Diasporës Shqiptare, ka thënë se derisa Kosova ka nevojë për krijim të vendeve të punës kjo mundësi do të ofrohet përmes rritjes së bashkëpunimit në mes të bizneseve vendore dhe atyre të diasporës. Si kryetar nderi pati edhe një kërkesë karshi bizneseve vendore dhe atyre të diasporës shqiptare. "Dëshiroj që të keni biseda këto dy ditë që jemi bashkë, mos përtoni ju kompanitë e vendeve këtu, por edhe të diasporës, që të bisedoni e të ofroheni më shumë me njëri-tjetrin sepse kështu jemi gjithmonë më të fortë. Kompanitë të cilat kanë ardhur nga diaspora unë jam më se i bindur se me vetë iniciativën, me vetë koston, kanë ardhur se

e duan Kosovën, e duan vendin dhe duan t'i ndihmojnë Kosovës", u shpreh Destani. Nënkryetari i Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane, Bekim Borovci, ka thënë se forume të tilla dëshmojnë përkushtimin e afarizmit kosovar për zhvillim ekonomik. Përfaqësuesja nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Shqipe Krasniqi, ka thënë se përmes takimeve rritet bashkëpunimi në mes të bizneseve në Kosovë dhe atyre në diasporë. Ajo ka theksuar se Ministria e Diasporës ka hartuar dokumente strategjike që ndihmojnë këtë lidhje. Këto konventa gjatë viteve të kaluara kanë zhvilluar 542 takime B2B mes 401 bizneseve të diasporës dhe 132 bizneseve të Kosovës, duke rezultuar me nënshkrim të 12 kontratave, 42 marrëveshje dhe oferta të reja të iniciuara dhe kontrata të reja të shitjes me vlerë 1.1 milion euro.



AKP-ja shpalli rezultatet e shitjeve përmes likuidimit nr. 52

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) të hënën, në ceremoninë e hapjes së ofertave të Shitjes së Aseteve në Likuidimin - 52 përmes metodës së likuidimit, shpalli çmimet më të larta të ofruara për asetet e ndërmarrjeve shoqërore që ishin në dispozicion

për shitje. Për 136 asete sa ishin në shitje konkurruan 114 ofertues, ndërsa vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 5,865,659 euro. Dorëzimi i ofertave nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve u bënë në mënyrë transparente,

para përfaqësuesve të mediave, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm. Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është e shtrirë dhe

vepron në të gjithë territorin e vendit. Agjencia ka mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve investitorëve private-blerësve, ose likuidimit e tyre, gjithnjë përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.



GLPS e quan të jashtëligjshëm vendimin e BQK-së për shtrenjtimin e sigurimit të automjeteve



Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka reaguar ndaj vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për rritjen e tarifave të sigurimit për automjete. GLPS-ja ka vlerësuar se vendimi i BQK-së përbën një ndërmarrje të nxituar, të pabazuar në konsultim të gjerë, përfshirë edhe komunitetin e konsumatorëve dhe në kohë të një tranzicioni institucional në të cilin BQK-ja mbetet e pakontrolluar nga Kuvendi sipas përcaktimit të normës kushtetuese

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka analizuar vendimin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për rritjen e tarifave të sigurimit për automjete, të cilin, sipas BQK-së, e ka ndërmarrë në procesin e rishikimit të primit të rrezikut për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia. GLPS-ja ka vlerësuar se vendimi i BQK-së përbën një ndërmarrje të nxituar, të pabazuar në konsultim të gjerë, përfshirë edhe komunitetin e konsumatorëve dhe në kohë të një tranzicioni institucional në të cilin BQK-ja mbetet e pakontrolluar nga Kuvendi sipas përcaktimit të normës kushtetuese. "Megjithatë Ligji për sigurimin e

detyrueshëm nga autopërgjegjësia (neni 8) dhe norma kushtetuese, i njohin në eksplisit BQK-së autorizimin për ta përcaktuar kufirin maksimal të primit dhe çmimin sigurues të tij, një gjë e tillë duhet siguruar që është në përputhje me ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal dhe social të tregut. Në rastin aktual, BQK-ja ka rritur tarifën e sigurimit të autopërgjegjësive në një përmasë galopante, duke u arsyetuar se ajo pasqyron normën e inflacionit 18-vjeçar të tregut në Kosovë. Në vlerësojmë se një arsyetim i tillë për një rritje të tillë galopante nuk mund të jetë i qëndrueshëm për disa arsye", thuhet në reagimin e GLPS-së. Sipas tyre, arsyeja e parë është se ky vendim është ndërmarrë në një kohë kur Kuvendi si organ që, sipas

Kushtetutës, mbikëqyr BQK-në, është i pakonstituuar dhe rrjedhimisht jofunksional. "BQK-ja nuk do të mund ta merrte një vendim me një impakt të tillë social dhe destabilizues në tregun e sigurimeve pa u pas konsultuar në mënyrë shteruese me komisionin gjegjës parlamentar dhe Kuvendin e Kosovës në përgjithësi. Kuvendi dhe komisionet e tij parlamentare mbrojnë interesin publik në mënyrën më të besueshme, prandaj edhe Kushtetuta dhe ligji parashikojnë mbikëqyrjen e BQK-së nga Kuvendi dhe komisionet e tij. Marrja e një vendimi të tillë në këtë terr institucional është abuzues dhe i papranueshëm", thuhet në reagim. Arsye e dytë, sipas GLPS-së, është se rritja e tarifave të

sigurimit të autopërgjegjësive, duke reflektuar kinsë inflacionin 18-vjeçar, është e papranueshme të bëhet përmes një vendimi të vetëm. "Kur ligji saktëson që BQK-ja bart kompetencën për ta përcaktuar strukturën e primit dhe çmimin e tarifave siguruese sipas ligjeve në fuqi, ajo i referohet jo vetëm interesit të siguruesit, por edhe të komunitetit konsumator, përkatësisht polic-mbajtësve. Rrjedhimisht, BQK-ja nuk mund të ndërmerre pas 18 vjetëve një rishikim të primit bazuar thjesht dhe vetëm në thirrje që janë reflektim i interesave të kompanive siguruese, duke anashkaluar kështu një analizë mbi impaktin social e konsumues të kësaj mase të nxituar ndaj policmbajtësve. Për më tepër, BQK-ja, si një rregullatore e pavarur e tregut financiar, nuk mund të imponojë masa që kanë efekt galopant në anën konsumuese të tregut, por me përgjegjësi të adresojë masa që gradualisht, nëse nevojat janë të arsyetuar, e reflektojnë rritjen. Çdo sjellje tjetër ndaj kësaj e vë në dyshim pavarësinë e saj politikbërëse dhe ruajtjen e dilgjencës që ajo duhet ta

tregojë ndaj palëve private në treg", thuhet në reagim.

Po sipas GLPS-së, rritja e tarifave të sigurimit të autopërgjegjësive për policmbajtësit e grupit tarifor 1 nuk mund të jetë hapi i parë në zinxhirin e hapave për të ashtuquajturin stabilizim të tregut të sigurimeve, për shkakun që BQK-ja njëherë duhet të ushtrojë një vlerësim rrënjësor të potencialit të shpëlarjes së parave të sektorit të sigurimit, rregullsisë së tyre në raport me zhvendimin e palëve, likuiditetit të tyre financiar dhe dilgjencës së tyre në tregun financiar dhe vetëm pasi të jenë stabilizuar tërë parametrat më thelbësor të tregut, të ndërmerret rishikimi i tarifave.

GLPS-ja ka kërkuar nga BQK-ja që ta revokojë vendimin e saj për rritjen e tarifave të sigurimit të autopërgjegjësive deri në konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe vetëm pasi të konsultojë në një dëgjim publik komisionin gjegjës parlamentar, Ministrinë e Financave, komunitetin e konsumatorëve dhe t'i publikojë rezultatet e rishikimit mbi parametra jo vetëm financiarë, por edhe të impaktit social, të vendosë për këtë çështje.

Sindikatat paralajmërojnë pasoja nëse nuk zbatohet Ligji për pagat

PRISHTINË, 25 NËNTOR (ER) - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës (SBASHK), ai i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës, kanë zhvilluar takim me Avokatin e Popullit, me qëllim të qartësimin të situatës



në lidhje me Ligjin për pagat. Në njoftimin e këtyre tri sindikatave është thënë se duke mos dashur të ndikojnë

në punën e Avokatit të Popullit, të njëjtin e kanë njoftuar se nëse pagat e muajit dhjetor nuk dalin sipas parashikimit me ligjin e ri, atëherë pasojat janë të paparashikueshme. "Nëse ky ligj nuk hyn në fuqi i atakon rreth 60 mijë të punësuar në sektorin publik dhe mund të imagjinohet se çfarë pasojat

sjell për ekonominë e tyre familjare", është thënë në njoftimin e sindikatave. Deputetët e legjislaturës së fundit të Kuvendit të Kosovës me 62 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim në muajin shkurt të këtij viti kishin miratuar Ligjin për Pagat në sektorin publik. Ligji pritet ta rregullojë

pagesën e të punësuarve që marrin rroga nga buxheti i shtetit, ku koeficienti më i lartë është 10 dhe më i ulët është 1 dhe vlera monetare e koeficientit për vitin e parë do të jetë 239 euro. Sipas afateve të parapara në ligj, nga muaji dhjetor i këtij viti punëtorët e sektorit publik pritet t'i marrin pagat me rritje.

Fillon ndërtimi i palestrës së sporteve në Astrazup



MALISHEVË, 25 NËNTOR (ER) - Në vigjilje të shënimit të festës kombëtare të flamurit, të hënën në Astrazup, përkatësisht në shkollën e fshatit, ka filluar ndërtimi i objektit të palestrës së sporteve e cila do të jetë në shërbim të shkollës dhe të rinjve sportistë të fshatit. Në ceremoninë e vënies së gurthemelit ishte i pranishëm kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, me bashkëpunëtorë, i cili edhe e vendosi betonin e parë

në themelet e këtij objekti. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm edhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, Rrahim Morina. "Uroj që nga kjo shkollë të dalin nxënës të shkëlqyeshëm në të gjitha fushat dhe uroj që të dalin edhe sportistë të formuar dhe të njohur, pasi me ndërtimin e sallës së sportit do t'i keni mundësitë më të mira për zhvillimin e orëve të edukatës fizike, por edhe të formoheni si

sportistë", ka thënë kryetari Begaj, duke u drejtuar nxënësve të ShFMU "Ganimete Tërbeshi" në Astrazup me rastin e fillimit të ndërtimit të këtij objekti me rëndësi për nxënësit dhe të rinjtë. Palestra e sporteve në Astrazup është projekt i cili financohet nga Komuna e Malishevës, e cila do t'i kushtojë buxhetit komunal mbi 240 mijë euro dhe punimet për ndërtimin e saj do të zgjatin dy vjet.

Komuna e Prizrenit, thirrje për OJQ-të dhe grupet rinore për pjesëmarrje në KVRL

PRIZREN, 25 NËNTOR (ER) - Komuna e Prizrenit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, u ka bërë thirrje të gjitha OJQ-ve dhe grupeve rinore që veprojnë brenda rajonit të Komunës së Prizrenit, si dhe të rinjve të interesuar për ta dhënë kontributin për zhvillimin e sektorit rinor, që të aplikojnë për pjesëmarrje në Kuvendin Zgjedhor të Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL). Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të dhe grupet rinore që kanë seli ose/dhe veprojnë në rajonin e Prizrenit, e që kanë të anëtarësuar brenda vetes të rinj nga mosha 15 deri në 24 vjeç si dhe



individë të kësaj moshe. Aplikimi do të jetë i hapur nga 25 nëntori deri më 15 dhjetor 2019. Pas shqyrtimit dhe aprovimit të aplikacioneve kuvendi zgjedhor do të mbahet më 21 dhjetor 2019 duke filluar nga ora 12:00 në sallën e Kuvendit Komunal të Prizrenit (Shtëpia e Bardhë).

Komuna e Rahovecit bëhet me sportel ndihmës për qytetarë

RAHOVEC, 25 NËNTOR (ER) - Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me organizatën joqeveritare Syri i Vizionit në Pejë, në kuadër të projektit "Qytetari Aktive", kanë promovuar të hënën sportelin ndihmës për qytetarët, i cili ndodhet në Administratën Komunale të Komunës së Rahovecit. Në ceremoninë e promovimit të sportelit ndihmës për qytetarë, të pranishëm ishin zyrtarë komunalë dhe kryetarë të këshillave të lagjeve dhe fshatrave të Komunës së Rahovecit. Me anë të këtij sporteli qytetarët do të kenë mundësi të parashtrajnë çështje dhe nevoja të ndryshme përmes formës zyrtare tek institucioni përgjegjës duke ndikuar kështu në rritjen e transparencës dhe



llogaridhënies ndaj qytetarëve. Qytetarët e interesuar për më shumë të dhëna mund të informohen përmes fletëpalosjes e cila është përgatitur, e ku qytetarët mund t'i gjejnë të gjitha informatat e duhura lidhur me sportel ndihmës për qytetarë.

Nga java e kaluar Komuna e Rahovecit ka publikuar numrin e telefonit 0800 11 007 pa pagesë, ku qytetarët e interesuar mund t'i adresojnë shqetësimet, ankesat, pyetjet apo edhe kërkesat për informata te zyrtarët komunalë.

Bëhen me ndriçim publik disa rrugë në Podujevë

PODUJEVË, 25 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, ka përfunduar finalizimin e projektit të ndriçimit publik në një segment të rrugës Podujevë - Kërpiemeh. Në kuadër të investimeve për rregullimin e infrastrukturës në Komunën e Podujevës sivjet janë realizuar projekte të ndriçimit publik në disa rrugë brenda në qytet dhe fshatra. Kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, ka bërë përfundimin e ndriçimit publik në rrugën Podujevë - Kërpiemeh, segmenti

nga qyteti deri në hyrje të fshatit Bajcinë, në një gjatësi prej 4 kilometrash. Me këtë rast, kryetari Veliu ka thënë se realizimi i këtij projekti dhe projekteve të tjera të ndriçimit publik ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve. "Edhe pse kjo është një rrugë regjionale, ne me mjetet e komunës kemi investuar edhe për ndërtimin e trotuareve edhe në ndriçim publik, pa ndihmën e ministrisë, me të vetmin qëllim: sigurinë e qytetarëve tanë", është shprehur Veliu. Më tej, kryetari Veliu ka pohuar

se projekte të ndriçimit publik janë realizuar edhe në disa rrugë të qytetit, përgjatë rrugës magjistrale deri në Merdar dhe një segment i rrugës rajonale në Orllan. Projekte të ndriçimit publik janë realizuar sivjet në shtatë rrugë të qytetit, në një gjatësi prej 2.6 kilometrash, si dhe janë duke u realizuar projektet në rrugën magjistrale Podujevë - Merdar, segmenti nga Shtedimi deri në Merdar, në gjatësi prej 2.7 kilometrash si dhe një segment i rrugës rajonale në Orllan në gjatësi 1.3 kilometra.



Më 28 nëntor në Mitrovicë organizohet ekspozita mbarëkombëtare Çmimi "Kadri Kadriu"

MITROVICË, 25 NËNTOR (ER) - Drejtuar nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, e në prani të nënkryetarit Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar disa pika të rendit të ditës që janë me interes për qytetarët e Komunës së Mitrovicës. Drejtori për Inspeksion, Hysni Ahmeti, ka njoftuar ekzekutivin



lidhur me aksionin e zhvilluar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës më 23.11.2019 dhe 24.11.2019, duke inspektuar sub-

jektet afariste lidhur me vendimin për respektimin e orarit të punës, me ç'rast vendimi për ditën e diel të jetë ditë pushimi për të gjitha bizneset në Mitrovicë është duke u respektuar në përpikëri.

Ndërsa drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Tafil Peci, ka thënë se për nder të festës së 28 nëntorit DKRS-ja ka organizuar ekspozitën mbarëkombëtare Çmimi

"Kadri Kadriu" e cila do të mbahet nesër, më 26 nëntor 2019, duke filluar nga ora 18:00, në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica", ndërsa më 27 nëntor do të bëhet shfaqja e teatrit të qytetit "Kur treni vonohet", nga ora 13:00 dhe në orën 15:00 në Qendrën e Kulturës. Po ashtu, drejtori Peci ka theksuar se më 28.11.2019, duke filluar nga ora 10:00, do të bëhen

homazhe te Varrezat e Dëshmorëve në Shipol, për të vazhduar te Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, pastaj te shtatorët e dëshmorëve Avni Shabani, Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, Fatime Hetemi, Artim Jashari, Harun Beka, Safet Boletini, Shemi Ahmeti, Mehë Uka, si dhe vizitë në kullën e heroit kombëtar Isa Boletini.

Gjashtë sulmet mbi nacionalizmin shqiptar



Shkruan: Blerim LATIFI

Së paku gjashtë sulme i janë bërë nacionalizmit shqiptar në dy dekadat e fundit.

1. Nga publicistët "kosmopolitë" të Sorosit, të cilët i janë sulur miteve e doktrinave të nacionalizmit shqiptar, në

emër të utopisë së shoqërisë së hapur globale, të cilën e financon miliarderi George Soros. Këta publicistë, në vazhdimësi, i kanë zhvilluar tezat se mitet nacionale mbi Skënderbeun, Rilindjen Kombëtare, Identitetin Kombëtar Shqiptar, janë pengesa për europeanizimin dhe demokratizimin e shoqërisë shqiptare, duke haruar faktin se ideali evropian i shqiptarëve është brenda vetë mitit nacional të Skënderbeut dhe vizionit të Rilindjes Kombëtare.

2. Nga salafistët e indoktrinuar në shkollat vahabiste të Arabisë

Saudite, të cilët i janë sulur nacionalizmit shqiptar, duke e quajtur atë trajtë të adhurimit dhe besnikërisë, që bie në kundërshtim me adhurimin absolutist të Allahut dhe besnikërinë ekskluzive ndaj tij. Kanë qenë të shumtë imamët e kësaj rryme të cilët hapur kanë bërë thirrje që monumentet e nacionalizmit shqiptar, siç është Kompleksi Memorial "Adem Jashari", të mos vizitohen e nderohen, sepse një gjë e tillë e shkelë parimin islam të adhurimit.

3. Nga mercenarët neo-otomanë të Erdoganit, të cilët i

kanë vënë vetes si detyrë, së pari, të njollosin dhe zhvlerësojnë secilën figurë e lëvizje shqiptare që i është kundërvënë Perandorisë Osmane, dhe, së dyti, të ushqejnë përpjekjet për një rishkrim të historisë shqiptare, sipas kërkesave dhe pikëpamjeve të historiografisë zyrtare turke.

4. Nga snobët multikulturalistë, të cilët kanë përbrendësuar diskursin fyes të elitave politike europiane për "nacionalizmat barbarë ballkanikë", duke haruar faktin themelor se nacionalizmi shqiptar nuk ka qenë pjesë e barbarive etnike

në Ballkan, për shkak të karakterit të tij defansiv.

5. Nga politikanët e korruptuar shqiptarë, andej dhe këndeje kufirit, të cilët me qeverisjet e tyre të këqija kanë ndikuar që shqiptarë të ndihen keq në atdheun e tyre, e ta përfetojnë identitetin e tyre kombëtar, jo si favor, por si pengesë në realizimin e ëndrrave të tyre për jetë më të mirë.

6. Nga kosovaristët naivë, të cilët besojnë se dispozitat juridike të Pakos së Ahtisarit janë ekuivalente me krijimin e një kombi kosovar, i ndryshëm nga kombi shqiptar.

TREPÇA

Trepça nuk është në krizë. Kosova është në krizë ekonomike. Trepça është zgjidhja e krizës ekonomike

Mr. sc. Bislim L. FETAHAJ,
inxh. dipl. i gjeologjisë

Trepça është dhuratë nga Zoti për Kosovën. Trepça dhe të gjitha pasuritë e tjera minerale të Kosovës për një qeveri të mençur, vizionare dhe atdhedashëse janë çelësi kryesor dhe garanci kryesore për zhvillim dhe përparim të vendit.

Nuk ka Trepçë veri e as Trepçë jug. Ka vetëm një Trepçë. Trepçë është: Albaniku, Cërncaci, Belloberda, Shatorica, Stantërgu, Zijaça, Melenica, Maxhera, Rashani, Batllava, Artana, Kaltërina, Përroi i Thartë, Kishnica, Hajvalia, Badoci etj.

Trepçë janë edhe zonat e lokacionet në të cilat me financime nga Trepça dhe me ekspertë nga Trepça janë bërë hulumtime gjeologjike komplekse dhe janë veçuar lokacione për hapje të minierave të reja. Trepça është Kosova.

Nga minierat e Trepçës janë nxjerrë miliona e miliona tonelata xehe të pasura me plumb-zink dhe elemente të tjera përcjellëse. Edhe përkundër kësaj, në Kosovë ka pasuri minerale, ka rezerva të sigurta të xeherorit të plumb-zinkut.

Çdo orvatje për ndërtimin e një plani ose strategjie për dalje nga kolapsi ekonomik, pa u mbështetur në pasuritë minerale të vendit, është dështim, siç është dështim edhe përpjekja për ta vazhduar praktikën e mëhershme të shfrytëzimit të xeherorëve, pa kriter përzgjedhjen vetëm të xeherorëve të pasur në një anë e në anën tjetër shkatërrimin dhe shëm-

timin e ambientit të vendit. Dëshmi për shfrytëzim të egër dhe pa kriter janë deponitë e mbetura të trajtuara si sterile.

Shfrytëzimi i vendburimeve polimetalore të Pb-Zn vetëm për prodhimin e koncentrateve nuk duhet të jetë qëllimi kryesor dhe nuk është rentabil. Ka vende në botë të cilat janë shumë të pasura me minerale të dobishme, por janë në grupin e vendeve jo të zhvilluara për faktin se nuk e kanë të zhvilluar industrinë e pasurimit dhe të përpunimit të lëndëve të para minerale.

Me studime paraprake rreth ndikimit të shfrytëzimit në ambient dhe me aplikimin e teknologjive të reja për shfrytëzimin dhe përpunimin e produkteve minerale, vërtet mund të arrihet që këto pasuri minerale të vihen në funksion të zhvillimit dhe të përpunimit të vendit dhe të mbarë shoqërisë. Por që t'i minimizojmë ndikimet negative në ambient nga këto veprimtari duhet të investohet në teknologji të reja të cilat garantojnë ndikim minimal negativ në ambient. Ligji e Statuti për Trepçën janë baza e hapjes së një kaptine të re për Trepçën dhe ekonominë e Kosovës. Kërkohej veprime të tjera konkrete për ringjallje të prodhimit në Trepçë, investime për fuqizim të kapaciteteve nxjerrëse në minierat ekzistuese, riaktivizim të minierave të braktisura, hapje të minierave të reja, investim në hulumtime gjeologjike për shtim të rezervave të reja të xeherorëve të plumb-zinkut dhe krahas kësaj investim në industrinë përpunuese. Pas investimeve në infrastrukturë



rrugore, më në fund duhet të kalohet në investime në Trepçë. Trepça nuk është në krizë. Kosova është në krizë ekonomike. Trepça është zgjidhja e krizës ekonomike. Si mundet me qenë Trepça në krizë, kur tash ka mbi 60 milionë tonë rezerva xeherore të plumb-zinkut, pa llogaritur në potencialin e madh në zonat e lokacionet e tjera të njohura për Trepçën. Trepça është në krizë për një qeveri vizionare, një qeveri e cila në rend të parë duhet ta dijë kush është Trepça, çka ngërthen në vete Trepça, çka do të thotë Trepça për Kosovën. Kriza financiare është pasojë e problemeve më tepër subjektive të cilat kanë rezultuar me prodhim të ulët që nuk po mbulohen shpenzimet nga mungesa e investimeve.

Pretendentet për gllabërim të Trepçës po lansojnë teza e po sajojnë gënjeshtër duke u munduar ta bindin opinionin e gjerë se Trepça është mit,

Trepça është dinozaur etj. Madje Serbia më humbje e ka mbajtur Trepçën. Krejt këta janë skenarë djallëzorë për privatizim. Nga këto gënjeshtër Trepça gati po shikohet si problem social me të cilën duhet marrë vetëm për hir të minatorëve.

Qeveritarë dhe deputetë në çdo takim e vizita të jashtme prezantojnë letra e dokumente për Trepçën. Krekosen se ka kompani të interesuara për investim e privatizim të Trepçës. Kurse në Trepçë vijnë vetëm në fushata. Po nuk është problem më gjet investitorë e të interesuar për privatizim të Trepçës. Problemi është si me e ngjallë Trepçën vetë shteti i Kosovës sepse kjo është lokomotiva e zhvillimit ekonomik. Privatizimi nuk është zgjidhje. Privatizimi i Trepçës nënkupton shkapërderdhjen dhe shkatërrimin e kompleksit të Trepçës, tjetërsim të pronave të Trepçës, humbje të emrit të Trepçës, shfrytëzim të egër e seleksionim

të xeherorëve etj. Askush në rajon e më gjerë nuk e do një Trepçë me kuptim të plotë të fjalës, për faktin se e dinë çka do të thotë Trepça për Kosovën dhe stabilitetin e shtetit. E duan një Trepçë me hapësirë për operim të firmave e kompanive të tipit të gurëthyesve, një Trepçë nga e cila marrin koncentrate të gatshme, Trepçë pa industri për përpunim të koncentrateve dhe finalizim të produkteve që dalin nga përpunimi i koncentrateve. Qeveria në ardhje urgjentisht duhet të gjejë rrugë për investime në Trepçë, por me çdo kusht duhet t'i ruajë aksionet e veta, të jetë titullare së bashku me aksionarin e dytë - minatorët. Neve na duhen njerëz që bëjnë zgjidhje dhe sjellin risi, njerëz që i shfrytëzojnë këto pasuri për të mirën e këtij vendi, njerëz që ua shumëfishojnë vlerën këtyre pasurive duke e lënë mënjandë bindjen e gabuar se vetëm me privatizim ngjallet Trepça.

GJUHA JONË E LASHTË



Sadulla Duraki- Zëvendës Kryeminister dhe Minister për Sistem Politik dhe Mardhënie Ndërmjet Bashkësive në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Maqedonisë , pas ndryshimit të Ligjit të gjuhëve jemi përcaktuar në zbatimin e tij.

Agjensia për përdorimin e gjuhëve dhe Inspektorati i gjuhëve, janë institucione të cilat do të ndihmojnë në këtë drejtim.

Të nderuar pjesmarrës,
Pasuria e këtij vendi është diversiteti.

Ne duhet të përfitojmë të gjithë nga ky shans i mrekullueshëm.

Prezenca e anëtarëve të Qeverisë në këtë manifestim, na inkurajon edhe më shumë, sepse është sinjal i qartë se në cilën rrugë është duke ecur vendi ynë.

Ministria për Sistem Politik dhe Mardhënie Ndërmjet Bashkësive do vazhdojë të punojë në drejtim të avansimit të gjitha gjuhëve të bashkësive etnike që jetojnë në këtë vend.

Miqtë tanë ndërkombëtarë janë shumë të mirseardhur dhe të nevojshëm në mbështjetjen e këtij procesi.

111 vjet pas Kongresit të Manastirit ne festojmë dhe nderojmë të gjithë ata që e mbajtën të gjallë këtë gjuhë me shekuj. Gjithashtu tregojmë përcaktimin tonë për të ruajtur e zhvilluar këtë thesar të madh, jo vetëm ne si shqiptar, por edhe institucionet botërore.

Ju falendëroj të gjithëve që keni ndarë nga koha juaj, për të ardhur në aktivitetet tona mbi Kongresin e Alfabetit!

Urime dita e shkronjave!
Faleminderit për vëmendjen!

Shkup, 22 Nëntor 2019!

Autori është
Zëvendëskryeminister dhe
Minister për Sistem Politik dhe
Mardhënie Ndërmjet Bashkësive
në Qeverinë e Republikës së
Maqedonisë së Veriut.

Sadulla DURAKI

I nderuar Kryetar i Parlamentit të Maqedonisë së Veriut z. Talat Xhaferi

I nderuar Kryeministër z. Zoran Zaev,

Shkëlqesitë tuaja, amabsadorë të vendeve tona mike,

Të respektuar kolegë Ministra, Kryetarë Komunash e drejtues tjerë të institucioneve,

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Zonja dhe Zotërinj,

Gjatë shekullit të 19-të dhe fillim të shekullit të 20-të, në Ballkanin e mbushur me turbulencë të mëdha politike.

Rilindasit shqiptarë kishin vendosur mbi të gjitha prioritetet: njësimin e shkrimit të gjuhës shqipe.

Gjuha jonë e lashtë kishte mbijetuar me mijëra vite, por ishte shkruar në alfabetet e ndryshme dhe kjo nuk mund të vazhdonte në pafundësi.

Në atë kohë armiqtë e shqiptarëve tentonin të na tjetëronin, duke pretenduar se disa janë turq, disa grek, e kështu me radhë.

Kjo rrugë ishte një rrugë e mbuluar me gjak, me vuajtje të papara. Si rrallë ndonjë popull në rruzullin tokësor, shqiptarët ishin të vendosur në mbrojtje të gjuhës së tyre.

Shoqëria " Bashkimi" nga Manastiri, ku ishte vatra e veprimtarisë kombëtare e mori përsipër bashkimin e intelektualëve shqiptarë nga 23 qytete, nga të gjitha vilajetet.

Delegacioni përbëhej nga shqiptarë të religjioneve të ndryshme: musliman, katolik, protestant

ortdoks - që i bashkonte gjuha dhe alfabeti shqip.

14 nëntori i vitit 1908 ishte dita kur filloi Kongresi i Manastirit dhe 8 ditët e ardhshme të punës, na 14 deri më 22 nëntor janë periudha e realizimit të ëndrrës së Alfabetit.

Kongresi ishte pasqyra e nivelit të ngritur intelektual të asaj kohe. Përveç alfabetit ka pasë edhe vendime politike që janë të njohura për historinë.

36 shkronjat e arta edhe pas unifikimit nuk e patën të lehtë të mbijetonin, sepse shkollat shqipe, paralelisht me fatin e kombit kaluan nëpër kohë të

vështira edhe pas pavarësisë së Shqipërisë të vitit 1912, duke vazhduar deri në kohët moderne. Vetëm para 31 vjetve, shkollat në gjuhën shqipe u mbyllën në emër të ideologjisë së paraleleve të përziera, në vitin 1988. Shpesh sinqerisht që të gjithë të kemi mësuar nga e kaluara.

Dhe mos të harrojmë, jemi duke folur gjithmonë për të drejtën themelore: atë të përdorimit të gjuhës së nënës.

Hapja e 3 universiteteve në gjuhën shqipe në vendin tonë, flet shumë për ndryshimet që kanë ndodhur.

Prandaj paragjykimet dhe frika

nga gjuha shqipe e atyre, që ende kanë dilema është e pavend. Nuk rrezikohet askush nga gjuha e tjetrit.

Të nderuar zonja dhe Zotërinj,

Një shtet multietnik, nënkupton edhe përdorim i gjuhëve të ndryshme.

Jo në dëm të gjuhëve të tjera, por si vlerë kulturore që begaton shoqërinë. Gjuha duhet të jetë elementi kyç i bashkëpunimit në mes të bashkësive etnike, sepse është elementi themelor i identitetit të kombit.

Pikërisht për këtë arsye , ne si Qeveri e Republikës së





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme


Një djalë vodhi 20 tonë çokollata

Kjo ndoshta është grabitja më e "ëmbël". Një i ri ka grabitur me kamion një sasi prej 20 tonë çokollatash. Ngjarja ka ndodhur në Austri, ku personi me kamion ishte prezantuar si përfaqësues i një firme, e cila kishte porositur çokollata në Belgjikë. Kamioni ishte me targa çeke dhe nëpërmjet mashtimit arriti ta merrte sasinë e ëmbëlsirave. Më vonë firma e çokollatës zbuloi



se dokumentet me të cilat ishte prezantuar kamioni ishin të falsifikuara. Çokollatat kapnin një shifër prej 50 mijë eurosh. Tani autoritetet po kërkojnë autorin e këtij krimi.

FOTO E DITES



Një punëtore në Bangladesh shihet duke rregulluar qeset plastike të përdorura. /AFP/

E rrallë

Përmbysët anija me 14 000 dele

Një anije që mbante më shumë se 14 000 dele është përmbysur në brigjet e Rumanisë. Queen Hind u përmbys të dielën pas largimit nga porti i Midias, afër qytetit juglindor Konstanza, në vijën bregdetare të Detit të Zi. Të gjithë anëtarët e ekipazhit, 22 shtetas sirianë shpëtuan. Në operacionin për shpëtimin e deleve u përfshi policia, zjarrfikëset dhe roja bregdetare rumune.



BARSOLETA E DITËS



Pyet djali babanë polic:

- Babi, sa dhëmbë ka goja?

- 36.

- Jo more babi, se mësuesja na tha se dhëmbë të përhershëm janë 32.

- Po, se i ngatërrova me shkronjat e alfabetit.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan




Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, **fb: Kino ABC.**




DASHI

Do të ndiheni të fuqishëm sot, prandaj përdoreni këtë energji që të përfundoni disa projekte të rëndësishme.



DEMI

Ju mund të përfundoni shumë gjëra sot. Shfrytëzoheni në maksimum ditën e sotme.



BINJAKËT

Merrni kontrollin e vendimeve tuaja. Ju dini si të veproni në çdo situatë.



GAFORRJA

Ju do të përjetoni disa përvoja shumë të mira sot. Ditë me fat për ju.



LUANI

Ju keni shumë energji sot, prandaj përdoreni atë në mënyrë konstruktive.



VIrgjëresha

Sot do të keni mësimë të rëndësishme që duhet t'i dëgjoni me kujdes.



PESHORJA

Sot duket se ka një atmosferë agresive rreth jush. Mundohuni që ju të jeni i qetë.



AKREPI

Fuqia nuk është pjesë e zakonshme e natyrës suaj, por nëse doni të largoni diçka nga jeta, sot është dita për ta bërë.



SHIGJETARI

Sot do të keni fuqi të madhe në dorë, por mos e përdorni për keq.



BRICJAPI

Zhytuni brenda në vetvete sot dhe jepini botës pak nga shpirti juaj.



UJORI

Fjalët tuaja do të kenë impakt të tmerrshëm sot, prandaj mendoni para se të flisni.



PESHQIT

Nëse duhet të bëni një punë serioze hulumtuese, sot është dita e duhur.

Justin Timberlake, për dore me një tjetër?



Këngëtari i martuar Justin Timberlake është parë duke ndenjur për dore dhe tejet i afërt me bashkëpunëtoren Alisha Wainwright. Sipas "Daily Mail", Timberlake dhe

Wainwright janë parë së bashku javën e kaluar në një bar në New Orleans. Këngëtari 38-vjeçar dhe aktorja 30-vjeçare shfaqen së bashku në dramën e ardhshme të futbollit Palmer.

Gjendet e vdekur artistja e njohur koreane



Këngëtarja dhe aktorja e Koresë së Jugut, Goo Hara, është gjetur e vdekur në shtëpinë e saj në Seul, ka bërë me dije policia, shkruan "BBC". Policia thotë se shkak i vdekjes është ende duke u hetuar. 28-

vjeçarja njihet më së shumti si anëtare e grupit K-Pop Kara, të cilit ajo iu bashkua në vitin 2008. Ajo u shfaq në disa performanca javën e kaluar, pas shtrimit në spital në maj, pas një përpjekje të supozuar për vetëvrasje.



Rita Ora vazhdon xhirimet e filmit "Twist"

Këngëtarja e njohur kosovare, Rita Ora, ka filluar të merret edhe me aktrim. Ajo është duke luajtur njërin nga rolet kryesore në filmin "Twist". Xhirimet e këtij filmi Ora është duke i zhvillu-

ar në Londër të Britanisë së Madhe. Para disa ditësh këngëtarja kishte thënë se është e sëmurë dhe i kishte ndërprerë për pak kohë xhirimet por, sipas "Daily Mail", ajo është duke i vazhduar ato.

Justin Bieber ndryshon ngjyrën e flokëve në rozë



Justin Bieberi ka qenë në kërkim të një shtëpie të re në Los Anxhelos me gruan Hailey. Dhe duket se vendbanimi i ri i planifikuar nuk është ndryshimi i vetëm që artisti ka bërë. Ai doli pasditen e së

dielës, duke zbuluar një të re të bërë me një kokë me flokë rozë karamele pambuku. 25-vjeçari fshehu pamjen për një moment nën një kapuç të gjelbër ndërsa shijonte një lojë jashtë shtëpisë të Beverly Hillsit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Limani: Ballkanin, si në kampionat, e mposhtim edhe në Kupë

Ballkani dhe Drita e ndajnë mejdantin të mërkurën në kuadër të rrethit të dytë të Digitalb Kupës së Kosovës. Ardian Limani e ka paralajmëruar skuadrën nga Suhareka se e pret humbja edhe në këtë ndeshje. "I gjithë fokusi ynë është në ndeshjen e Kupës kundër Ballkanit. Normalisht se është shumë e vështirë ndeshja pasi ata po tregojnë se kanë skuadër shumë të fortë, mirëpo ne e kemi dëshmuar se mund t'i mposhtim ata. Drita, si gjithmonë, në çdo ndeshje futet për fitore", ka thënë Limani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Skuadra e Dritës nga Gjilani, në kuadër të xhiros së dhjetë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, e kishte mposhtur Ballkanin (2-0). Kjo fitore dhe forma e mirë e bëjnë optimist kapitenin e skuadrës nga Gjilani, Ardian Limani. Ky i fundit të hënën për "Epokën e re" ka thënë se Drita në secilën ndeshje hyn për fitore dhe e njëjta gjë vlen edhe për ndeshjen e rrethit të dytë të Kupës kundër Ballkanit. "I gjithë fokusi ynë është në ndeshjen e Kupës kundër Ballkanit. Normalisht se është shumë e vështirë ndeshja pasi po tregojnë se kanë skuadër shumë të fortë, mirëpo ne kemi dëshmuar se mund t'i mposhtim ata. Drita, si gjithmonë, në çdo ndeshje futet për fitore", ka thënë Limani, i cili nuk ka folur për ndeshjen e ardhshme në Superligë që Drita e zhvillon në "Riza Lushta" ndaj Trepçës '89. "Sinqerisht nuk e kemi diskutuar ndeshjen me Trepçën '89, pasi ne çdoherë i marrim ndeshjet një nga një, prandaj i gjithë fokusi ynë është në ndeshjen e Kupës", ka shtuar ai. Drita në fundjavë e mposhti skuadrën e Llapit (2-0) dhe në këtë mënyrë e mori pozitën e dytë në elitë, me tri pikë më pak se Ballkani i Suharekës. Lidhur me rezultat e gjertanishme, Limani bëri me dije se pritshmeritë ishin më të mëdha. "Në përgjithësi kemi pritur diçka më shumë, por disa gabime na kanë kush-



tuar gjatë këtij stinori. Megjithatë, jemi në garë për titull dhe kjo është mirë. Jemi duke u përmirësuar vazhdimisht dhe nuk duhet të gabojmë më gjatë rrugës sikur kemi bërë më parë", ka deklaruar Limani.

Drita është e dyta në tabelë me 31 pikë, kurse nga gjashtëmbëdhjetë ndeshje të zhvilluara ka regjistruar 9 fitore, 4 barazime dhe 3 humbje.

Ballkani 'kërcënon' Dritën me humbje

Lideri i elitës, Ballkani, duket se ka synime të mëdha edhe në garën e Kupës,

pasi të hënën ky klub nëpërmjet faqes zyrtare e ka "kërcënuar" Dritën me humbje në ndeshjen e rrethit të dytë të Kupës. "FC Ballkani në sezonin paraprak ka lënë një mision të papërbushur, duke e mbaruar aventurën për Kupë në gjysmëfinale. Këtë herë kapiteni Visar Berisha me shokë, në veçanti me tre musketarët (Blend Baftiu, Jetmir Topalli, Arbër Hoxha) janë të etur që të rrëmbejnë këtë titull me renome në vendin tonë, andaj do të bëjmë çmos për të filluar mbarë këtë garë kundrejt FC Drita. Klubi ynë nuk ka plan B, vetëm fitorja është opsion", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ballkanit.

SHKURT

'Tuttomercatoweb' e ngrit në qiell Rrahmanin

Hellas Verona e Amir Rrahmanit po vazhdon me paraqitje të mira në kampionatin elitare të Italisë. Skuadra e Ivan Jurijit ka regjistruar fitore të rëndësishme ndaj Fiorentinës (1-0) dhe, si zakonisht, mbrojtësi i Kosovës, Amir Rrahmani, luajti gjithë ndeshjen për Veronën. Për paraqitjen e Rrahmanit ka shkruar edhe mediu i mirënjohur italian "Tuttomercatoweb". "Një gjigant në mbrojtje dhe një mjeshtër i topave në ajër. Gjithashtu, nuk i la asnjë hapësirë Riberys dhe ishte më i miri nga lojtarët në repartin e mbrojtjes", ka shkruar "Tuttomercatoweb".

Ndërroi jetë menaxheri i kompanisë 'Tiks.app', Ardian Kelmendi

Menaxheri i kompanisë "Tiks.app", që merret me shitjen e biletave online të Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Ardian Kelmendi, ka ndërruar jetë të hënën. Lajmin e ka konfirmuar kolegu i Kelmendit, Edi Kolgeci, i cili është nënkryetar i Klubit të Hendbollit Prishtina. Ndërsa Federata e Futbollit të Kosovës e ka ngushëlluar familjen e të ndjerit Ardian Kelmendi.

Liria mbetet pa trajner, Nikaj jep dorëheqje

Samuel Nikaj nuk është më trajner i skuadrës së Lirisë, pasi ka dhënë dorëheqje pas humbjes që pësoi në fundjavë nga Malisheva. "Pas përfundimit të xhirove të para me 7 fitore, 4 barazime dhe 4 humbje, duke mbledhur 25 pikë, që për pritshmëritë e mia janë shumë pak marrë krejt përgjegjësitë dhe dorëhiqem duke e lënë klubin ende në luftë për vendin e parë, pasi është vetëm një pikë larg". "I falënderoj pa përjashtim, për këta gjashtë muaj të kaluar te Liria (një klub i madh) të gjithë bashkëpunëtorët, që nga kryetari, drejtori, stafi im i ngushtë dhe ekonomat dhe u uroj suksese në vazhdim...", ka shtuar Nikaj, i cili kishte arritur që Flamurtarin e më pas Vushtrinë t'i rikthejë në Superligë.

Sonte derbi Ylli - Bashkimi

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Të martën dhe të mërkurën do të zhvillohet xhiroja e 13-të e Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshja më interesante në këtë xhiro është ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit. Therandasit kanë grumbulluar 17 pikë, duke u renditur në vendin e katërt, kurse dy pozita më lart është Bashkimi, që ka grumbulluar 18 pikë. Në edicionet e fundit takimet ndërm-

jet këtyre dy skuadrave kanë qenë interesante dhe kështu pritet të jetë edhe të martën mbrëma në palestrën '13 Qershori' në Therandë. Ndërkohë, lideri Rahoveci do të ndeshet me Trepçën. Vreshtarët e kanë nisur këtë edicion për mrekulli, ku kanë dhjetë fitore dhe një humbje, kurse mitrovicasit kanë dy fitore dhe tetë humbje. Të mërkurën do të përballen Peja dhe Feronikeli që



kanë nga 14 pikë, por pejanët kanë një ndeshje më pak të zhvilluar, andaj ndeshja në 'Karagaçi' pritet të jetë shumë

interesante. Po të mërkurën, Ponte Prizreni, që ka gjashtë fitore dhe pesë humbje, do të sfidohet nga Lipjani, që edhe më

tutje nuk ka shënuar fitore në elitë, duke pësuar 11 humbje. Sigal Prishtina pushon në këtë xhiro.

Superliga - Java 13

Të martën takohen:

19:00 Rahoveci - Trepça

19:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi

Të mërkurën takohen:

19:00 Peja - Feronikeli

19:00 Ponte Prizreni - Lipjani

'Elkos Group', 'Sponsor i Artë' i xhudos

PEJË, 25 NËNTOR - Federata e Xhudos në Kosovë të hënën ka firmosur marrëveshjen me sponsorin e ri 'Elkos Group-Etc'. Presidenti i 'Elkos Group-Etc', Ramiz Kelmendi,

ka bërë me dije se marrëveshja është nënshkruar për një vit. "Në praninë e selektorit dhe trajnerit me famë botërore Driton Kuka dhe kampiones absolute botërore

të xhudos Majlinda Kelmendi, bashkërisht me kryetarin e Federatës së Xhudos të Kosovës, Agron Kuka, formalizuar edhe zyrtarisht marrëveshjen me të cilën 'Elkos

Group' si 'Sponsor i Artë' mbështet sukseset e xhudos kosovare me 180 mijë euro në vit", ka shkruar Ramiz Kelmendi në llogarinë e vet në "Facebook".



Kosova përfundoi me humbje turneun në Turqi

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Hendbollistet e Përfaqësueses së Kosovës të hënën e kanë luajtur ndeshjen e fundit në turneun ndërkombëtar të mbajtur në Antalya të Turqisë. Në ndeshjen e fundit 'dardanet' humbën nga Maqedonia Veriore me rezultat 30:27. Humbja erdhi si pasojë e lodhjes dhe lëshimit të koncentrimit. Vashat e Kosovës kanë luajtur katër ndeshje të forta brenda tri ditëve. Mbi dhjetë herë hndbollistet e Kosovës kanë goditur shtyllën. Ndonëse angazhimi ishte maksimal, kjo ndoshta ishte ndeshja më e zbehtë në turneun e zhvilluar në Antalya. Kosova ka fituar ndaj Italisë dhe Turqisë B, kurse ka pësuar nga Turqia A dhe Maqedonia Veriore. Kundër Maqedonisë Veriore prapë me efikasitet shumë të lartë është shquar kapitenia Leonora Demaj që ka shënuar 12 gola. Shtabi teknik i përfaqësueses e ka vlerësuar shumë të suksesshëm turneun në Turqi. Qëllimi që ishte vënë për këtë pjesëmarrje është realizuar në tërësi, ndonëse për nga cilësia e shfaqur, Kosova është dashur të ketë të paktën tri fitore. Gjatë qëndrimit në Antalya janë provuar lojtare të reja, ndërsa motrat Marigona dhe Arlinda Hajdari janë dëshmuar si për-



Maqedonia Veriore - Kosova 30:27 (17:13)

Maqedonia Veriore: Cakidova 4, Brizovska, Tasevska, Markovic, Gjorgjevska 8, Serafimova, Sedlovska, Nikolov, Jankurovska 6, Stojanovska 6, Micevska, Kipranovska, Kaladjjevska, Djatevska, Livrinka 2, Sazdovska 4.

Kosova: Ahmetxhekaj, Istrefi, Mehmeti 4, Kursani, A. Hajdari 3, Kelmendi, Rugova 2, Uka, Stagova, Gjirkokaj 2, Demaj 12, Lekaj, Kastrati, Bytyqi 3, M. Hajdari 1, Ujkiq.

forcime të mëdha. Në nivel të lartë është paraqitur edhe Mirjeta Bytyqi, kurse vlera kanë shfaqur edhe lojtaret e tjera. Duhet cekur se Kosova në Antalya është paraqitur pa thujtje gjysmën e

ekipit. Për shkak të angazhimeve personale kanë munguar Albana Arifi, Dorentina Osmani, Elma Kameri, Ardiana Merditaj, Fitore Aliu, Aurora Shehdadi, Meltem Ylberi e disa lojtare të tjera.

Dallasi triumfon ndaj Houstonit

HOUSTON, 25 NËNTOR - Pesë fitore radhazi për Dallas Mavericksin dhe sërish paraqitje mbresëlënëse e Luka Donçiqit. Talenti 20-vjeçar sloven ishte protagonist absolut në suksesin e skuadrës së tij 123-137 në parketin e Houston Rocketsit, ku iu kushtua më shumë rëndësi spektaklit sesa lojës mbrojtëse, sidomos në pjesën e parë që u mbyll me avantazhin e thellë 29-45 të Mavericksit. Rocketsi arriti ta ngushtojnë në vetëm 5 pikë diferencën në fillim të periodes së fundit, por Donçiq vendosi t'i mbyllte llogaritë e në fund rezultoi lojtari më i mirë i ndeshjes me 41 pikë, 10 asistime e 6 "rebounde". Ndihmëse të madhe në këtë sukses të Mavericksit dha edhe Tim Hardaway me 31 pikë, ndërsa për Rockets James Hardeni iu afrua "triple-double" me 29 pikë, 11 asistime dhe 8 "rebounde". Edhe Los Angeles Clippers shënuan



fitoren e pestë radhazi, duke iu imponuar 134-109 New Orleans Pelicansit në "Staples Center". Paraqitje super e Montrezl Harrell, autor i 34 pikëve dhe 12

REZULTATET

Houston R. - Dallas M.	123-137
New York K. - Brooklyn N.	101-103
Washington W. - Sacramento K.	106-113
Denver N. - Phoenix S.	116-104
LA Clippers - New Orleans P.	134-109

"reboundeve", ndërsa Kawhi Leonard e Paul George realizuan respektivisht 26 dhe 18 pikë. Për miqtë më i miri rezultoi Ingram me vetëm 24 pikë. Po në Perëndim, Denver Nuggets i mposhti Phoenix Suns-in 116-104. Vendimtare perioda e katërt, gjatë së cilës Jokiçi me shokë shënuan një rezultat të pjesshëm në favor 37-27. Shënuesi më i mirë rezultoi Millsap me 23 pikë.

SHKURT

Interi po e monitoron Kumbullën

Marash Kumbulla është një nga mbrojtësit më të talentuar në Serinë A dhe këtë edicion ka shkëlqyer. Falë paraqitjeve të tij të mira edhe Verona ka marrë rezultate të shkëlqyeshme në këtë fillim edicioni, duke qenë mbrojtja e dytë më e mirë në Serinë A pas asaj të Juventusit. Marash Kumbulla dhe Amir Rrahmani pa dyshim që kanë meritat më të mëdha për këtë ecuri fantastike të Veronës. E për mbrojtësin e talentuar të Kombëtares së Shqipërisë interesim ka shfaqur Interi që prej kohësh është duke e ndjekur. Këtë e ka konfirmuar edhe menaxheri i lojtarit Gianlucini. "Po, Interi po e monitoron Kumbullën. Klubi zikalitër është gjithmonë shumë i vëmendshëm ndaj profileve të rinj që bien në sy në elitë dhe në të gjithë kampionatet e tjerë. Në këtë çast nuk flitet për negociata të hapura mes Interit dhe Veronës", ka thënë Vitale për mediet italiane.

Wilder: Ja pse Joshua i frikësohet përballjes me mua

I mjaftoi vetëm një grusht i fuqishëm në raundin e shtatë për ta hedhur "KO" kubanezin Luis Ortiz, që deri në ato çaste po duelonte mirë. Boksieri amerikan Deontay Wilder tregoi edhe një herë forcën e tij teksa korri mëngjesin e të dielës suksesin 42 në karrierë (41 me KO), duke mbrojtur titullin kampion bote në peshën e rëndë (kategoria WBC). Pas këtij dueli, Wilderi i ka dërguar një mesazh Anthony Joshuas, me të cilin nuk është përballur kurrë. "Tani besoj se e kuptuat arsyen e vërtetë përse Joshua nuk duelon me mua. Ata nuk duan që të turpërohen me boksierin e tyre. Mua më mjafton vetëm një grusht për ta hedhur KO edhe Joshuan. Gjithsesi, unë e pres në ring nëse e mund Ruizin, që të kemi vetëm një kampion të vërtetë", ka thënë Wilderi.

Mbappe: Messi e meriton 'Topin e Artë'

Sulmuesi i PSG-së, Kylian Mbappe, ka folur në mënyrë konkrete për një nga ngjarjet më të rëndësishme të futbollit të këtij viti, ose dhënien e "Topit të Artë" 2019. "Messi. Pa dyshim se ai ishte më i miri individualisht në këtë vit kalendarik", ka thënë Mbappe.

Del Piero kritikon Ronaldon

Reagimi i Cristiano Ronaldos, pas zëvendësimit në ndeshjen e Juves me Milanin, ka qenë një çështje e "nxehtë" te bardhezinjtë, që nuk ka lënë shije të mirë. Ylli portugez jo vetëm se nuk i dha dorën Sarrit, por ai u largua për në dhomat e zhveshjes dhe nuk priti shokët duke lënë më përpara stadiumin. Ish-kapiteni legjendar i Juventusit, Alesandro Del Piero, gjatë një interviste për mediat italiane ka pohuar se gjesti i Ronaldos nuk ishte i bukur. "Të ikësh nga stadiumi para se të mbyllet ndeshja nuk është një veprim i bukur për një lojtar si Ronaldo. Megjithatë, ajo që ka më shumë rëndësi është sjellja e tij në përditshmëri. Cristiano është një profesionist i madh. Starti i sezonit nuk ka qenë i mirë, por diferencën ai mund ta bëjë një shkurt", ka deklaruar Del Piero.

Vidali nuk largohet në janar nga Barça

Mesfushori Arturo Vidal kishte shumë dyshime për statusin e tij te Barcelona dhe po planifikonte të largohej nga klubi spanjoll në janar. Roli i tij i kufizuar në fillimin e sezonit, me Busquets, De Jong dhe Arthur, që formonin treshen titullare të mesfushës, bëri që mesfushori kilian të shikonte skenarë të tjerë. Mirëpo tani Vidal i ka tejkualuar pritshmëritë, ku ka shënuar 4 gola në 12 ndeshje, ndërsa sezonin e kaluar ai shënoi 3 në 53 takime. Tashmë me më shumë autoritet dhe vlerësim te "blaugranat", në Itali e kanë të qartë se në janar është e përjashtuar që ai të shkojë tek Interi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
SHËNDETI MENDOR
PROFESIONALNA SHËRBIMI I SHËNDETËSISË
PROFESSIONAL MENTAL HEALTH SERVICE

Nr. Pril: 02/05
Br. stranica: 4
No. pages: 4
Data: 26.11.19
Date: 26.11.19
PRIZREN



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-Hospital and University Clinical Service of Kosovo
Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi -Prizren
Community based Mental Health Centre and Houses for Integration-Prizren
Centar mentalnog zdravlja sa domovima za integrisanje u zajednici-Prizren

Në bazë të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr. 03/L-212, nenit 4, të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, kërkesës për rekrutim nr. 58/01 datë: 09.10.2019, të aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, Drejtori i Qendrës së Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim-Prizren shpallë:

KONKURS PUBLIK

Titulli i pozitës së punës: Infermier-e i përgjithshëm (Bachelor) ose Infermier-e i përgjithshëm
Njësia: Qendra e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi-Prizren
Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar me periudhë provuese 3 (tre) mujore
Koeficienti: (5.40),(4.80)
Orari: 40 orë në javë
Nr i Referencës: QSHM-SHIB-26/11/19

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Do të punojë si pjesëtar/e i/ e ekipit të kujdesit mjekësorë, në ofrimin e standardit me të lartë të kujdesit shëndetësor të përqendruar në pacientin, duke siguruar në çdo kohë kujdes të duhur dhe të sigurt për pacientët.
- Zbaton politikat integruese dhe udhëzimet organizative për standardet profesionale,
- Të zbatojë të gjitha aktivitetet profesionale specifike për profesionin dhe shërbimin ku punon.
- Të caktojë, planifikojë, zbatojë dhe vlerësojë kujdesin ndaj të sëmurit në përputhje me politikën e aprovuar.
- Merr pjesë në zhvillimin profesional / zhvilluar praktiken infermierike,
- Sipas nevojës ti asistojë pacientit në mbajtje të higjienës personale, gjatë të ushqyerit, kryerjes së nevojave fiziologjike dhe aktiviteteve tjera që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien e pacientit.
- Të kontribuojë në krijim të një mjedisi të sigurt klinik për të gjithë pacientët dhe kolegët.
- Të sigurojë komunikim të mirë gjatë dorëzimit të detyrës pas orarit të punës si dhe të dhëna të sakta për pacientët për të cilët është kujdesur gjatë tërë orarit të tij/ saj të punës.
- Të u ofron pacientëve informata të sakta dhe të qarta lidhur me kujdesin i cili iu ofrohet atyre.
- Të kontribuojë në mbajtje të pastërtisë dhe higjienës në mjedisin ku punon dhe të punojë gjithnjë në përputhje me udhëzuesit mbi kontrollin e infeksionit.
- Të administrojë terapinë e përshkruar në përputhje me politikën Institucionale.
- Të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalim të dekubitit.
- Të përdor dhe të mirëmbajë në mënyrë të duhur dhe të sigurt të gjitha pajisjet.
- Të asistojë në hartimin e udhëzuesve procedurave të shkruara mbi punën e infermiereve.

Qendra e Shëndetit Mendor-Prizren tel: 029/623-931 029/623-760

- Të marrë pjesë në mbledhjet e ekipit sipas specifikave të shërbimit,
- Të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara sipas programeve për njësi të caktuara me qëllim të shkëmbimit të njohurive dhe informative në mes të personelit shëndetësor.
